

TJETËR*
2025
POLITIKË

POLITIKË | 2025

- 01 **Mësimi nga Zgjedhjet e 9 shkurtit: Qysh mendon një votues?!**
Nga Jetlir Buja
- 02 **Çka shkroi shefi i KEDS-it si arsye për shtrenjtim të rrymës?**
Nga Tjetër*
- 03 **Kur s'ke çka bën, lëvize 'Fatmir Limajn'**
Nga Tjetër*
- 04 **136 debate televizive LIVE për katër ditë: A po devalvohet fjala publike?**
Nga Tjetër*
- 05 **Më duhet vëmendja jote. Jam tregtar i vëmendjes. Qe çka di unë.**
Nga Tjetër*
- 06 **Kosovës po i prishet truri. Punë e madhe!**
Nga Tjetër*
- 07 **Shfaqja horror e djalit të Trumpit me Vuçiqin në Beograd**
Nga Tjetër*
- 08 **Malli për Hashim Thaçin dhe plakja e tij 'u krijuan' nga algoritmat e Facebook-ut**
Nga Tjetër*
- 09 **Pse shtetet s'po luftojnë më si përpara?!**
Nga Tjetër*
- 10 **Poshtërimi publik i Baton Haxhiut për zbavitje personale**
Nga Tjetër*
- 11 **Jooooo: Miliarderit të parë shqiptar në Forbes i dalin lidhjet me Serbinë**
Nga Tjetër*
- 12 **Bullizmi ndaj Agim Bahtirit është bërë i tepërt**
Nga Jetlir Buja
- 13 **Kur grandioziteti i Kurtit kthehet në krizë institucionale**
Nga Tjetër*
- 14 **Kur ishte zhvillimi i fundit politik në Kosovë?**
Nga Jetlir Buja
- 15 **Qesharake, e frikshme, e rrezikshme: Elaborimi i Trumpit për Serbi-Kosovë**
Nga Tjetër*
- 16 **Deputeti ukrainas që lobon për Kosovën bën jehonë të madhe ndërkombëtare**
Nga Tjetër*
- 17 **Surroi e Vllasi u nxehën aq shumë me Jugosllavi sa eskaluan në sharje ndaj Demaçit**
Nga Jetlir Buja

18 **Shkrimi në Evropë që tregon qysh biznesmenët po i kapin mediat e Kosovës**

Nga Tjetër*

19 **Rita Knudsen: Kush është gruaja e Albin Kurtit?**

Nga Tjetër*

Mësimi nga Zgjedhjet e 9 shkurtit: Qysh mendon një votues?!

Nga Jetlir Buja

“Albin Kurti ka tendenca autoritare!” – po vajton opozita. Po, edhe?! Çka të bëjmë me këtë informacion?!

Një deputet i opozitës u pagua 20 mijë euro në vit ose 80 mijë euro për katër vjet prej taksave tona. Pa i llogaritë medijtjet. S’janë pak për standardin tonë. A s’ishte punë e deputetëve opozitarë me i frenu ato tendenca?!

E, e keqja është se opozita s’po ndalet te vaji. Disa prej tyre edhe po e fyejnë e po e tallin votuesin kundërshtar. Qysh mund të jetë dikush kaq haptas kundërproduktiv?!

Unë pajtohem që Albin Kurti ka prirje autoritare. Por, puna është që secila parti politike në thelbin e saj i ka këto prirje. Po e shohim këtë gjë edhe në demokracitë më të zhvilluara të botës. Sa më shumë që beson te bindjet e veta një parti, ose edhe individ, aq më autoritar bëhet. Ky është realiteti. Prirje antidemokratike s’ka veç Kurti. Ka edhe PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, Lista e Familjes, Lëvizja e Deçanit. Lidhja e historianëve të Deçanit. Manastiri i Deçanit etj.

Hajt të mendojmë pak kundërintuitivisht. Çka nëse problemi s’qëndron te shpërfaqja e autoritarizmit të Kurtit por te mos-shpërfaqja e autoritarizmit të opozitës? Domethënë, çka nëse demokracia është një farë lufte legjitime mes politikanëve me tendenca autoritare të detyruar nga njëri-tjetri me i respektu rregullat? (Kushtetutën, ligjet) Çka nëse ajo ‘prirje demokratike’ e PDK-së është thjesht fasadë që e mbulon mungesën e bindjeve dhe qëndrimeve të njëmendta politike? Çka nëse ajo mungesë bindjesh e qëndrimesh të njëmendta – ajo mungesë ‘prirjesh autoritare’ prej tyre – po ia shtron udhën drejt autoritarizmit kundërshtarit? Çka nëse Kurti po bëhet autoritar sepse opozita s’po bëhet opozitare?

E di që mund të duket qesharake. Por, pritni pak!

I.

Rezultati i zgjedhjeve të 9 shkurtit – nëse jo me nxitë mendim kundërintuitiv – të paktën do t’i nxis do mendime të reja te votuesi i partisë opozitare. Sidomos te ai që e ka seriozisht kundërshtinë ndaj Kurtit. Ky votues do t’i shtrojë – qoftë edhe veç vetëmevete – disa pyetje legjitime e disa tjera jolegjitime:

“A po më përfaqësojnë mirë? A po i fitojnë betejat politike? Pse humbën prapë kaq thellë ndaj Kurtit? Pse Kurti dukej më i zoti se këta edhe kur i kishte veç 10% të votave?”

Diskutimet më domethënëse politike nuk zhvillohen në ndonjë studio televizive apo ndonjë forum. Ato zhvillohen – të parrjedhshme, ilogjike, ndoshta veç me fjalë njërrrokëshe, ofshama, piskama – brenda kokës së qytetarit. Aty merret vendimi se kujt t’i ipet vota; kush të shahet në Facebook e kush

të mbrohet. Ama ky diskutim brenda mendjes së qytetarit e ka një nxitës. Hint : s’është arsyeja.

Botëkuptimi i deritashëm i opozitës tonë thotë pak-a-shumë: “ah, sikur të kuptonte votuesi i VV-së më shumë fakte!” Pra, “ah sikur të shihte atë çka po e shohin ata.” “Ah sikur të ishte më i dijshtëm.” “Ah sikur të kishte më shumë informacione.”

Pritni veç pak!

II.

Mospajtimet tona politike s’janë thjesht keqkuptime. Nuk është se po të informoheshim më shumë, do të pajtoheshim me njëri-tjetrin. Informimi është... çështje identitare.

Një profesor në Amerikë me emrin Dan Kahan e ka bërë një studim para do kohe që na e dëshmon këtë gjë. Një pjesë e madhe gazetarësh e politologësh s’e kuptonin pse shumica e njerëzve në Amerikë s’pajtoheshin me faktet për ngrohjen globale. Për herë të parë pata dëgju për studimin e Kahan para nja 5-6 viteve në një artikull që titullohej: “Qysh na bën politika budallenj” .

Studimi i atij profesori zbuloi që njerëzit nënvetëdijshtëm iu rezistojnë fakteve të cilat ua rrezikojnë vlerat e tyre themelore.

Pra, badihava ti i thua dikujt që Albin Kurti ka prirje autoritare dhe ia gjen një varg fjalimesh apo veprimesh ku nxitet kjo gjë. Dialogu i brendshëm në kokën e qytetarit nuk nxitet nga nevoja e rivlerësimit të vazhdueshëm kritik të vlerave e bindjeve në të cilat beson. Ai dialog nxitet prej nevojës së përforcimit të atyre vlerave e bindjeve. Sepse, ato vlera e bindje – mes tyre edhe Kurti – bëhen pjesë qendrore e identitetit të tij.

Kështu jemi të gjithë, na thotë ai studim. Askush prej nesh s’do që përditë me i cenu ato gjëra që e përcaktojnë.

Dhe, mbajeni mend se ky farë dialogu zhvillohet brenda kokës tonë. E koka jonë s’është si DeepSeek-u i Kinës që e zbulon hapur procesin e të menduarit. Ne këtë proces e kemi të fshehtë. Dhe, siç e dimë të gjithë, ky proces i të menduarit na korruptohet prej lidhjeve emocionale, kohës së shkurtër, nervave të dobëta apo edhe aftësive kognitive. E na korruptohet më së rëndi prej identitetit.

Rezultatet e studimit të lartpërmendur e dëshmuar teorinë që na thotë se aftësitë tona njohëse bazohen në mbrojtjen e identitetit (ang. Identity-Protective Cognition). Pra, ne mbledhim informata jo për me sfida veten por për me përforcu përkatësinë tonë. Dhe kjo bëhet veçanërisht e fortë kur polarizimet shoqërore bëhen të mëdha – në të cilat, identiteti

ynë vihet nën kërcënim . E kur ndërrimi i mendimit kërkon sakrificë të madhe personale.

Të paktën tash për tash, identitetet politike e kulturore mes nesh – meqë ende jemi shoqëri tranzicioni – janë deridiku fluide. Ka edhe qytetarë që e ndërrojnë mendjen pa kurrfarë problemi. Nëpër qendra urbane vota është luhatë vazhdimisht deri në këto zgjedhje. Por, polarizimi politik po na rritet dhe kjo i nxit njerëzit gjithnjë e më shumë me kriju identitete në bazë të bindjeve politike. Po e shohim këtë gjë para syve tanë: përplot njerëz në rrjete sociale janë në gjendje të ushtrojnë dhunë të pabesueshme verbale për Albin Kurtin.

III.

Çka ka të bëjë këtu opozita?

Opozita s'duhet të qajë gjithë ditën duke thënë se qytetarët po injorojnë faktet. Është në natyrën tonë me i injoru faktet. Çështja është: çfarë përfaqësimi, përkatësie, identiteti po i ofrojnë partitë opozitare votuesve të tyre?

Unë besoj që paradigma e pasluftës që iu kërkonte koordinim konstant me miqtë ndërkombëtarë e ka zënë frymën zhvillimit të mendimeve e bindjeve të reja politike. Një pjesë e madhe opozitarësh s'po i zënë besë vetes me mendu në mënyrë vetjake as për çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë.

E në politikë, nëse s'identifikohesh me politika të caktuara, gjithçka tjetër bëhet irrelevante me kalimin e kohës. Kjo i ka lënë pa identitet politik edhe votuesit e tyre. I ka lënë efektivisht edhe pa përfaqësim. Prandaj, edhe votat që i marrin PDK-ja me LDK-në i marrin veç shkaku i ish-liderëve dhe shkaku i zhgënjimit të njerëzve me Kurtin. Ama jo sepse njerëzit iu besojnë atyre.

Në anën tjetër, Kurti na e ofron një shembull krejt tjetër. E vërtetë që i ka shkelë dhjetëra qëndrime politike. Por, të paktën i ka pasë ato qëndrime përmes të cilave e ka kriju identitetin e tij. Sot njerëzit identifikohen me të. E bëjnë tatuazh kokën e tij. Fyejnë në emër të tij. Dhe këto, sado vulgare të na duken, përbëjnë sukses në politikën tonë nëse për një moment heqim gjykimet morale.

Kurti ka pasë komunikim tepër strategjik e të kujdesshëm me qytetarët. Ka operu përmes simbolesh e alegorish të cilat e kanë ndiku atë dialogun jotransparent të qytetarit me veten. Kurti e ka fitu vazhdimisht luftën e perceptimeve. Por, e mira e demokracisë është se ofron gjithmonë fusha të reja luftime.

A do t'i shfrytëzojë opozita? S'e besoj. LDK-ja i ka bërë disa hapa të gabuar duke provu me kalu në një farë të djathtë që s'i përgjigjet rrethanave tona. PDK-ja krejt mish-mash. Qe shiheni Qeverinë Në Hije të PDK-së. Klikoni në cilindro Departament – ekuivalenti i ministrive – për me kuptu çka është vizioni e çka është puna e tyre. S'ka asgjë.

IV.

Autoritarizmi i Kurtit s'do të mjaftojë si argument për mbështetësit e opozitës këtej e tutje.

Ajo çka i duhet opozitës është krijimi i një identiteti të qartë përmes të cilit qytetarët që i mbështesin të krenohen e të mbushen me shpresë. Nuk mjafton thjesht evidentimi i një të keqeje. Duhet të ofrohet edhe alternativa për të.

Ky identitet nuk krijohet përmes ngjyrash e logosh e billboardesh, siç na ndodhi në fushatë. Krijohet përmes një tregimi të qartë e koherent. Ta zëmë, nëse besojnë Kurti është autoritar atëherë PDK-ja e LDK-ja do të duhej me ofru shembuj të thjeshtë e të prekshëm të demokracive të tyre. Por, a janë se?

Kosovës i duhet një opozitë e fortë. E një opozitë e fortë s'bëhet kurrë nëse ka shkujesje në komunikim e injorancë të plotë mbi perceptimet e krijuara. S'fitohet kurrqysh nëse ia merr inati qytetarëve pse s'duan me u identifiku me ty. Bile as atyre që votojnë baza provinciale apo banalitete tjera.

Pra, nuk është çështja veç te faktet që ofrohen në debatin publik. Çështja është: çfarë identiteti i jep ti qytetarit. Puna kryesore e opozitës në mandatin e kaluar ishte definimi i Albin Kurtit. Me i tregu qytetarit se kush është ai. S'funksionon. Puna kryesore e partive opozitare këtë mandat duhet me qenë definimi i vetes. Kush janë? Në çka besojnë? Në çka jo?

Nëse opozita krejt shpresat për rritje – apo edhe mbijetesë – i varë te gabimet apo skandalet e mundshme të Kurtit, atëherë... e pret një fat i keq.

Kaq kësaj here.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

Çka shkroi shefi i KEDS-it si arsye për shtrenjtim të rrymës?

Nga Tjetër*

Më 20 shkurt, ditë e enjte – ditë kur Fatmir Limaj do t'i thoshte fjalët virale që pushtuan rrjetin – KEDS-i do ta alarmonte popullin e Kosovës: i kishte zënë disa taksi në Prishtinë duke e vjedhë rrymën.

“Kurrresi të mbushet mend!” – shkruante KEDS -i në Facebook për kompaninë e taksive.

Admini i faqes së KEDS-it tha se e kishte zënë pronarin e kësaj kompanie të taksive duke vjedhë rrymë edhe në muajin tetor . Kjo kompani e taksive operonte me vetura elektrike. Kuku, kuku, kuku!

Një javë më parë, KEDS-i ishte nervozu edhe më zi: “SKANDALISHT! Stan-Tërg: TRAFQO në qendër të vëmendjes për vjedhje masive!”

“...më shumë se gjysma e rrymës vidhet pa turp !” Imagjioni! Drita juaj, e ardhmja juaj po rrezikohen...”

Kjo nervozë s'është që s'na frikëson! Fundja, KEDS-i e ka në dorë rrymën, dhe... mundet me na e ndalë. E derisa këto alarme e leksione morale po bëheshin në Facebook, po ata kishin kërku shtrenjtim të çmimit të energjisë elektrike në ZRRE-në e famshme. Bashkë me KOSTT-in dhe KESCO-n.

Një diskutim i madh publik kishte fillu nëpër platforma si Facebook apo në studio televizive. S'e dimë mendimin e pronarit të kompanisë së taksive me rrymë. Meqë e vjedhte rrymën, e shumë gjasë është kundër shtrenjtimit.

Nejse.

Kjo e nxiti Zyren e Rregullatorit me dalë me një sqarim . Aty thoshte se ende s'kishte asnjë vendim, por inkurajonte konsultimin publik.

“Deri në publikimin e raportit për konsultim publik, ZRRE-ja nuk mund të japë asnjë qëndrim për mundësinë e ndryshimeve të tarifave të energjisë elektrike për vitin 2025.” – shkruante ZRRE-ja.

Para këtij sqarimi kishte një tjetër , ku thuhej se komentet nga palët e interesuara mund të dorëzoheshin deri më 26 shkurt 2025. Pra, deri sot. Si duket, ky afat u shtye pas presionit publik.

Ndërkohë që vlonte diskutimi, Facebook-u i KEDS-it s'e thoshte asnjë fjalë për kërkesën e tyre që të shtrenjtohej energjia elektrike. Ishte i zënë në qortimin e vjedhësve të rrymës.

Nejse, e gjetëm kërkesën. Ndodhet në faqen e ZRRE-së. Ishte shkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i KEDS-it – jo nga admini i faqes në Facebook – me emrin Alpin Dogan. Alpin, jo Albin. Dhe Dogan, jo Erdogan.

Arsyet

Arsyet e paraqitura në këtë letër janë – për ne – të mjegullta.

Albin Erdogani – na falni, Alpin Dogani – merrej edhe me rritjen e pagës minimale në 350 euro. Sipas tij, KEDS-in e kishte dëmtu kjo gjë sepse... nënkontraktorët tash duhej t'i paguanin punëtorët e sigurimit të objekteve fizike e të mirëmbajtjes me rrogë 350 euro.

Ajo që kuptuam nga kjo është se punëtorët e nënkontraktorëve të KEDS-it – gjithë kësaj kompanie, hej – paguheshin më pak se 350 euro. Kjo i kishte rritë kostot për ta. Por, në letër s'fregojhej sa saktë.

Por, ka edhe arsytetime tjera: “...Për shkak të parashikimit jo të saktë të energjisë së prodhuar në vend, është shfaqur nevoja për të mbuluar kërkesën përmes importit të energjisë elektrike. Çmimet e larta të importit kanë rezultuar në një kosto shtesë prej mbi 37 milionë eurove krahasuar me nivelin e lejuar nga ZRRE...”

Kryeshefi i KEDS-it thoshte edhe se nëse nuk shtrenjtohej çmimi i rrymës aëtherë kjo e rriste rrezikun për “operim dhe zvogëlon kapacitetin për të bërë investime të nevojshme në infrastrukturë dhe shërbime.”

Përveç kësaj, në këtë letër ai thotë se mos-shtrenjtimi i rrymës çon edhe në mos-rritjen e pagave për punëtorët e KEDS-it. Diçka që sipas tyre do t'i demotivonte më tej ata duke i shtyrë edhe që të largoheshin.

Në letër, kryeshefi na flet edhe për tjera arsye. Ndërkohë, është e zorshme të kuptohen e verifikohen shifrat e paraqitura në mënyrë që me pasë mendim më të informuar. Fatmirësisht, nuk përmendi direkt taksistët apo vjedhjet në Stan-tërg.

Por, pse s'u postuan këto në Facebook si “Skandali” në Stantërg apo mosmbushja mend e pronarit të taksive në Prishtinë? Publiku do të ishte shumë më mirënjohës.

LETRA E PLOTË .

Kur s'ke çka bën, lëvizje 'Fatmir Limajn'

Nga Tjetër*

Gatishmëria e Fatmir Limajt për me hy në një koalicion qeveritar e 'habiti' fort popullin. E habiti deri në atë pikë, sa mbrëmë Ermal Panduri – zbuluesi i asaj gatishmërie – luante topash me të.

Ishte mbrëmja e 20 shkurtit kur Fatmir Limaj na u shfaq nëpër televizorë e nëpër Facebook.. I kishte bërë edhe nja 'tre milionë' intervista tjera këto muajt e fundit, por s'ka lidhje.

Tash e pesëmbëdhjetë vjet s'thotë diçka të re , por s'ka lidhje. Është i harxhuar deri te zoti, por s'ka lidhje. Kjo s'i nxjerr telashe që ai secilën herë të shfaqet sikur ka diçka të re për të thënë. E normal, s'ka!

Por, ja që kësaj here – bingo! – ia doli mbanë. U bë lajm!

Ishte mbrëmja e 20 shkurtit – mbrëmje historike – kur ai tha se ishte i gatshëm me hy në koalicion qeveritar. Populli hapi gojën prej habie. Kush mund ta kishte mendu se Fatmir Limaj – hej, Fatmir Limaj – ishte i gatshëm me hy në koalicion qeveritar?

Përgjigja, për të gjithë është e qartë deri në bezdi: TË GJITHË!

Po, po, po, po. Të gjithë e dimë se çfarë qëndrimesh ka Fatmir Limaj, bile pa e çelë gojën hiç. S'ka asnjë skutë në mendjen e asnjë personi në Kosovë ku çudia ka vend. Hiç askund.

Fatmir Limaj është i harxhuar deri në molisje e i parashikueshëm deri te zoti.

E çka u bë atëherë? Çka ishte gjithë ajo çudi? Qysh ka mundësi që çudia e Fatmir Limajt me zgjatë më shumë se tri ditë – siç thotë populli se zgjat çudia më e madhe?

Përgjigja edhe këtu është tepër e thjeshtë: sepse ishte çudi artificiale .

Ishte çudi e fabrikuar nga faqe Facebook-u me mijëra ndjekës.

E fabrikuar edhe nga fakti se të gjithë politikanët kryesorë, si përnjëherë, ranë me një heshtje të plotë. Ndoshta, të rraskapitur nga fushata e gjatë. 9 shkurti i Zgjedhjeve është 16 ditë larg prej sot. Albin Kurti s'bën asgjë. As Lumir Abdixhiku. As Bedri Hamza. As Ramush Haradinaj. Pas tensionit e dramës që prodhuan zgjedhjet u prodhu një farë etje për ndonjë lëvizje, çfarëdo qoftë.

Dhe... kjo na e prodhoi Fatmir Limajn.

Por, ka diçka më tragjike

Por, ka diçka më tragjike se kaq.

Ermal Panduri – që është afër ta shndërroj RTV Dukagjinit në RTV që prodhon debat 24 orë në ditë (e ndoshta ia ndërron edhe emrin në RTV Debati – s'kishte pasë kurrfarë pritjesh prej asaj

interviste me Fatmir Limajn. Shiheni sa herë ka qenë Limaj në emisionin e tij (kliko KËTU).

E prandaj, kur fjalët e Limajt morën jehonë – prej memeve të FB-së e deri te reagimet 'serioze' gjeopolitike të Sadri Ramabasë – Panduri u çudit. Qysh? Pse? Limaj, a?

Çudinë e Pandurit me çudinë e popullit e kuptuam dje. Ermal Panduri disa herë gjatë emisionit të mbrëmshëm – që me gjasë s'po i ecte mirë – iu tha shikuesve që të rrinin me e këqyr atë emision sepse në fund do të tregonte çka i kishte thënë Fatmir Limaj pas emisionit. Ishte përpjekje e lodhtë që të luante topash* me popullin, derisa merre pak shikueshmëri prej fenomenit Limaj.

Natyrisht, emisionit i erdhi fundi dhe s'u tha asgjë. Asgjë tjetër pas emisionit s'i kishte thënë Fatmir Limaj. Por, s'është puna te një rrenë e keqe e e lirë që e thotë dikush në televizion. Te përgjegjësia e fjalës publike. Më thellë është puna.

Por, Ermal Panduri si duket s'po kuptonte diçka edhe më serioze: populli s'është aq budallë. Befasia e popullit me Limajn s'është befasi hiç. Është shtirje. Populli e di që s'ka lajm te Fatmir Limaj sot e 700 vjet, por bëhet sikur ka lajm. Reagimi i tij ishte përgjithësisht artificial .

E kjo është brenja jonë: populli e ka fitu aftësinë me rrejtë veten në sy pa u skuqë; populli po prodhon rrena kolektive.

*Është fjala për poezinë e famshme të Abetares: "hopa-hopa; luajmë topa; tap andej; e tap kënde!"

**Dy fjalë seriozisht: Fatmir Limaj besohet se i ka fitu tre deputetë (ende s'kemi rezultate përfundimtare) në koalicionin me AAK-në. Edhe nëse Limaj i vetëm e pa Haradinajn shkon te Kurti, ky s'përbën ndonjë farë akti tradhtie. Limaj në ato tre milionë intervista që i ka pasë, ka folë gjithmonë për unitet, për bashkim, për 'o djem mani more'. etj.

136 debate televizive LIVE për katër ditë: A po devalvohet fjala publike?

Nga Tjetër*

A e keni dëgju kur thonë votimi është obligim qytetar. Ju kanë rrejtë. Shumë më i rëndësishëm për demokracinë është debati publik. Pjesëmarrja e qytetarëve në debat publik. Ky është obligim qytetar. Nëse bindja jote është mos me votu, dhe ti voton, atëherë je duke e shkelë bindjen tënde. Votimi pa debat, pa fjalë të lirë, pa transparencë është veç iluzion. Ka votu mileti edhe në sistemin e Enver Hoxhës.

Eh, debatet pra. Në dukje të parë, demokracia e Kosovës duket se po lulëzon: debate televizive në të majtë e në të djathtë. Por, mos nuk kemi lulëzim e kemi vëshkaje?! Mos këto debate televizive në fakt... s'janë debate hiç?!

Eh, ajo që do ta mësoni në këtë video do t'iu lë pa fjalë! Mbajeni frymën!

Magazina Tjetër i përcolli këto debate veç për katër ditë. Nga 23 deri më 26 qershor. E hënë – e enjte. Provuam ta kuptonim se sa debate kishte në Kosovë. Çfarë debate. Sa po shikoheshin. Dhe më e rëndësishmja: a i kontribuonin a jo demokracisë?!

I përcollëm tetë televizione me frekuencë kombëtare. Dhe i përcollëm veç në YouTube. Përgjatë këtyre katër ditëve na u shfaqën LIVE plot 39 emisione debati e bisede . Pra, 39 talk/show e show debati të ndryshëm që u futën LIVE plot 136 herë . E nëse i numërojmë krejt emisionet e debatit – pra, edhe ato që s'i futën LIVE, emisionet e vikendit, sportit etj. – numri shkon në... kupë të qiellit. Mbi 100.

Gjatë këtyre ditëve – veç katër ditë, po e përsërisim – kishte përmbajtje debati e bisede për 166 orë e 39 minuta. Pra, për katër ditë janë prodhu shtatë ditë përmbajtje debati e bisede në Kosovën tonë të vogël. Rrini ju rrini! Ky të dashur përcjellës të magazinës TJETËR quhet prodhim industrial.

Meqë ra fjala, mos harroni të na e bëni Subscribe në Youtube. Pashë allahun! Ty s'të kushton hiç, e neve na ndihmon shumë!

Vzhdojmë! Ja po i marrim televizionet një nga një.

T7-shi transmetoi për katër ditë emisione debati prej 16 orësh e tre minutash në vetëm tri emisione: Pressing, Kosova Live dhe Frontal. Por, T7 i ka edhe gjashtë emisione tjera bisede aktualisht aktive e të cilat përgjatë këtyre ditëve s'i futën LIVE. Zanat nga Zana Avdiu, ku bisedohet për gratë dhe jetën para vdekjes. Majtas, jo Djathtas nga Shkodran Hoti ku diskutohet për gjithçka. Favorit, ku diskutohet kryesisht për futboll dhe jetën pas vdekjes. Shneta ku diskutohet për shëndetin. Euro n'T7 e Menduh Abazit ku flitet për euron . Dhe, Prizma e Dritan Dragushës ku diskutohet për vdekjen para jetës.

RTV Dukagjini shfaqti LIVE emisione debati për 29 orë e 59 minuta e 42 sekonda .

KTV-ja shfaqti në YouTube emisione debati e bisede për 9 orë e 24 minuta e 5 sekonda. Kanal10 shfaqti emisione për 19 orë e 18 minuta. ATV-ja shfaqti emisione për 21 orë e 41 minuta. TëVë1 shfaqti LIVE në YouTube emisione për 24 orë e 49 minuta. RTV21 shfaqti një debat të vetëm që e ka për 4 orë e 25 minuta. Ndërsa Klan Kosova është kampione. Shfaqti emisione me biseda e debate në YouTube live për 40 orë e 59 minuta e 51 sekonda. Po e përsërisim: veç për katër ditë. Kur ia shton kësaj që Devollët po e hapin edhe një televizion tjetër, D1 CNN, e që do të shfaqë përmbajtje lajmesh e debatesh e bisedash 24 orë i bie se do të përmblytemi.

Kush shikohet më shumë?!

Debati më i shikuar në Kosovë është bindshëm Debat Plus. Mbi 100 mijë shikime përgjatë katër ditëve. Ndërsa, vendi i dytë s'e ka as gjysmën e këtyre shikimeve. Por, ia vlen të thuhet se një numër i madh debatesh kanë tepër tepër pak shikime gjë që na çon drejt poentës tonë.

Gjithëprania e debateve dhe bisedave televizive po bën devalvimin e debatit e të fjalës publike. Shihni se si janë organizu debatet politike. Komercializmi është ashikare thelbi i tyre.

Në debatet më të shikuara (që janë ato politike) e kemi një kurdisje tepër transparente të një dikotomie: në një anë njerëz pro-Kurti e në tjetrën njerëz anti-Kurti. Është pra kjo dikotomi që i prodhon përplasjet e piskamat e nevojshme për spektakël. Shikuesi lodhet kur dikush ia sfidon a zgjeron të menduarit. Kësisoj, ai e pret përplasjen në mënyrë që në një anë t'i përforcohen bindjen dhe në tjetrën të argëtohet si i shfrenuar. Ku po e dimë? Prej përzgjedhjes së klipëve që prehen e shpërndahen në rrjete sociale nga këto media. Ato e dinë që populli kërkon polarizim. Dhe iu jep polarizim. Demokracia në lesh.

A vlerësohet elaborimi i ndonjë panelisti? Rrallë e hiç. Nuk ka ndonjë klip të prerë ku shfaqet një argument në mënyrë elokuente.

T'i kthehemi debatit më të shikuar në Kosovë: Debat Plus. Dikotomia aty është mjeshtëruar aq mirë sa është kopjuar edhe në emisionin e sportit të Dukagjinit për një kohë të gjatë. Veçse aty pika përplasese s'ishte Albin Kurti por Agim Ademi. Dhe funksiononte. U bë i famshëm Faruk Statovci. U bënë të famshëm edhe të tjerë.

Po e përsërisim: në ato shifrat e mësipërme s'është futë fare asnjë emision sportiv debati (e ju e dini që secili prej këtyre televizioneve e ka të paktën një emision të tillë).

Nejse, t'i kthehemi shpërfytyrimit që po i bëhet debatit publik. Mungesa e zhvillimeve politike i ka ekspozuar edhe më

shumë mekanizmat e debatit. Nuk ndodhë asgjë hiç, por debatet largime dramatike nga studiot e debateve?! Eh. vazhdojnë. Dhe kësisoji, përfundojnë duke folur për të njëjtën gjë. Ajo çka bëjnë është thjesht ta ndërrojnë pak titullin e debatit. E bile nganjëherë s'e ndërrojnë fare.

Më 3 qershor 2021: Dialogu dhe Albin Kurti .

Më 21 prill 2021: Albin Kurti dhe Dialogu .

Më 20 korrik 2021: Albin Kurti dhe Dialogu.

Më 22 mars 2023: Kurti dhe Dialogu.

Edhe kur e ndërrojnë titullin, përfundojnë sërish duke folur për aktualitetin politik. Një prej analistëve, Jusuf Thaçi, me një sinqeritet të papritur dha dorëheqje prej analisti duke u shprehur se po i duhej të përsëritej. Po pra, si analist të bie që të përsëritesh sepse s'ke çka thua kur flet 200 mijë herë për një temë.

Pse Debat Plusi e fitoi garën me debatet tjera? Krahas dikotomisë që e përmendëm, një arsye tjetër është edhe sepse moderatori i saj Ermal Panduri e ka të qartë rolin e tij si aktor. Rri gjithë kohës në këmbë. Ecë ose edhe vrapon. Bërtet. Thërret njerëz në telefon pa asnjë paralajmërim për me i inkuadru në emision. Paralajmëron gjëra që del se s'ishin asgjë fare. I bën të madhe edhe ato që thonë mysafirët, kur e sheh që numri i shikimeve po bie. Mund të tingëllojnë banale, por kur e prodhon një spektakël këto janë obligative.

E kur e krahasoni gjithë atë shpurdhje të Ermal Pandurit me Leonard Kërçukin që mezi rri në karrigen e tij gjatë debatit... mundeni me kuptu pse njëri e pse tjetri.

Por, më në margjina janë dhjetëra emisione tjera debati që nuk i këqyr kush. Për me fitu ndonjë shikim, ajo çka detyrohen të bëjnë është e frikshme. Disa madje edhe e maskojnë veten si debate, dhe shfaqen me tituj sensacionalistë si lajme. Me shumë gjasë iu ka ndodhu të klikoni një lajm, për me kuptu që në fakt s'është lajm por debat. Qe ku e keni një rast . E me ndonjë rast tjetër, mediat edhe e japin titullin për reklamë si ky rast . Hiç pa titull, pse a!

E dëmi më i dukshëm bëhet bash aty ku ndodhë debati i vërtetë publik: te seksioni i komenteve të këtyre emisioneve. Fyerjet aty janë të një niveli tmerrues. Abuzimi ndaj panelistëve apo edhe njëri-tjetrit është për turp. Ndërkohë, moderim të atij debati nga këto emisione debati s'ka megjithëse do të ishte tepër lehtë (secili debat ka producentë, ka njerëz për rrjete sociale, ka kameranë). Dhe kësisoji, krejt çka mbetet në fund është mllefi dhe frustrimi i këtyre njerëzve si monument i atij bërlloku.

166 orë e 39 minuta debat për katër ditë është përnjëmend shumë. Por, arsyeja nuk është se kemi dashuri të madhe kombëtare për debatet. E as fetish. Arsyeja është ekonomike. Prodhimi i një debati kërkon pak mendim, pak para e gati hiç organizim. Televizionet tona kombëtare mezi mbahen në këmbë, dhe mu për atë arsye po eksploatohet delli demokratik i shoqërisë.

Ne parashohim që debatet të eskalojnë edhe më zi. Pse? Sepse shikuesit tashmë janë mërëzitur me përsëritjen mërëzitore të debateve. Kosova po i njuh kufijtë e imagjinatës politike.

A e keni vërejt qysh viteve të fundit po kemi shpeshim edhe

S'ka zhvillime domethënëse. E as s'do të ketë. Për atë arsye, do të kemi inskenim të turli budallallëku vetëm e vetëm që vëmendja të mbetet aty.

Ndërkohë, demokracia jonë do të rrudhet e do të rrudhet.

Më duhet vëmendja jote. Jam tregtar i vëmendjes. Qe çka di unë.

Nga Tjetër*

Puna ma kërkon që me marrë vëmendje. Qe më shumë se 13 vjetër drejtoj një emision televiziv lajmesh, dhe kur s'jam në punë e harxhoj kohën duke lexu lajme në internet dhe duke postu me obsesion nëpër rrjete sociale. I them vetes që po e bëj sepse e kam punë, se duhet gjithqysh, si detyrë profesioni për me mbajtë hapin me lajmin por kjo është njësoj si një drejtor i kompanive të cigareve me i pi dy pako cigaresh në ditë.

“Pse jam kështu?” – e pyes veten. E puna është që s'jam veç unu kështu.

Prej pikëpamjes time – qoftë si tregtar i vëmendjes, qoftë si një konsumator i sëmurë – është e qartë se vështirësia me qëndru në “dhomën e vetmisë” – siç e ka përshkruar filozofi Blaise Pascal lirinë e të qenit vetëm me mendimet e tua – po na përkeqet nga forma e kapitalizmit të vëmendjes në të cilën jemi nguju.

Vëmendja jonë është një resurs tepër i vlefshëm, dhe disa prej korporatave më të fuqishme të botës po e vjedhin masivisht në forma gjithnjë e më të pavërejtshme duke na lënë si spektatorë të mendjeve tona. Mund të themi se e kemi ndërtu një makinë që prodhon bajatësi* dhe më pas e mbush atë bajatësi me zbavitje në një cikël që përshpejtohet e përshpejtohet pafund.

Bajatësia fshihet në çdo kënd të jetëve tona. Unë kam nis ta shoh, specifikisht shmangien ndaj saj, si motorin e heshtur që jetëve moderne. Vëmendja, vendi ku i ngulisim mendimet tona në një moment të dhënë, është substanca e jetës. Jemi tepër të vetëdijshëm për ata vjedhës konstant të vëmendjes tonë – cingërrimën e telefonit, me njoftime të mesazheve, me shenjat e kuqe të njoftimeve që na lajmërojnë se ndodhi diçka që duhet me i kushtu vëmendje.

Të ndodhur nën këtë sulm, është kollaj me u ndi sikur jemi të bllokuar në një kohë që s'na lë hapësirë që thjesht të ulemi e të mendojmë. Por, ia vlen të thuhet se përveç që ekzistojnë këto forma të kapitalizmit të vëmendjes që duan ta vjedhin atë vëmendje, ekziston edhe diçka e thellë brenda nesh që do që ajo me na u vjedhë.

Kur Trumpi fitoi për herë të dytë, një postim në Twitter nga viti 2016 u bë viral përsëri: “Më vjen keq për vendin tonë (që u zgjedh Trumpi president). Por, kjo do të na japë kontent të jashtëzakonshëm.”

Ndoshta tingëllonte më qesharake para se të ndodhte ndarja e fëmijëve nga prindërit apo edhe Covidi. Por, për miliona amerikanë, ndoshta përfshirë edhe një pjesë të madhe të votuesve të pavendosur që i dhanë votën në nëntorin e 2024-s, Trumpi është makinë e përsosur kontenti. Qoftë nëse e doni, qoftë nëse e urreni, duhet me pranë se ai i bën gjërat interesante. Kam pyetur veten bile se mos e përdori këtë truk

që me marrë fitoren e ngushtë: Mos e zgjidhën amerikanët përsëri sepse thjesht status quo-ja iu kishte bërë bajat?

Prej krejt asaj që mund të na ngjajë – prej çmendurisë e sëmundjes, apo traumave të luftës – bajatësia duket gjë e parëndësishme. Kemi prirjen që me lidhë përvojën e bajatësisë me fëmijërinë – kur s'na rrihej në klasë, kur kalonim ditë të gjata vere pa bërë asgjë. Por, e kujtojmë fëmijërinë sepse kur rritëm dhe e morëm kontrollin e kohës tonë në dorë, bëmë gjithçka që mundëm që mos me përjetu më vetmi. Cili prind s'e ka përjetu momentin e refuzimit të kërkesës së fëmijës së tij për me qëndru në telefon dhe më pas e ka pa veten vetë në telefon?

E megjithatë, bajatësia – për dallim prej, hajt po themi urisë – nuk është një përvojë univernale njerëzore. Antropologët që kanë punuar me popujt indigjenë që jetojnë jashta modernitetit industrial nga Fixhi e deri në Eukador e Australi, kallëzojnë që këto shoqëri harxhojnë male e dete me kohë pa bërë asgjë, dhe kurrë s'ankohen se janë mërzi. Gjuhët e tyre shpesh bile as s'e kanë hiç fjalën mërzi, bajat. Antropologu ynë që ka punu me popullin Warlpiri në Australi shkruan: “Kur ky popull i referohet bajatësisë, e përdor fjalën në anglisht.” Na del pra, se bajatësia është përvojë e lindur në modernitet.

E megjithatë e ndjejmë këtë pandërpre; vajtojmë pse vëmendjet tona po zvogëlohen. Por përqendrimi te një pyetje e ngushtë e një mase teknike për gjatësinë e vëmendjes na largon nga një e vërtetë më e thellë. Shqetësimi dhe parreshtja e kohëve tona s'janë thjesht, të paktën për mua, vertigoja e zbavitjes e shpërqendrimin. Jo, ajo përvojë është vetiu simptomë e shkaktuar nga diçka më e thellë brenda vetes tonë që s'gjen rehati. Zbavitja e pafundmë që na ofrohet neve e që na bën të jemi gjithmonë afër telefonëve tanë bën që kurrë të mos e kuptojmë qysh me jetu veç me mendjen tonë.

Për shumë vite, si një plak, kam dalë me ecë përditë. E kam fillu në të njëzetat, kur si gazetar i pavarur punoja gjithë ditën ose në shtëpi ose nëpër kafeteri. Më bënte mirë të dilja e të ecja që me qetësu mendjen. Bile dilja edhe në ditët më të acarta të dimrave të Chicagos, kur era ta shpon fytyrën si shpatë. Ia nisa këtij zakoni përpara kohës së smartfonëve e bile edhe para kohës së podkastave në iPod. Gjatë ecjeve thjesht... mendoja. E lija mendjen të lodronte. Gati pa përjashtim, mendimet më të mira më vinin gjatë këtyre ecjeve. Më pas kthehesha në laptop, nganjëherë duke vrapu deri në banesë, dhe i shkruaja ato mendime.

Ka shumë fjalë me përshkru gjendjen mendore që aq shumë e doja gjatë atyre ecjeve: ëndërrim me sytë çelë, fantazim, përhumbje në mendim. Dhe që të jem i qartë, ka variacione që janë më pak të këndshme. Me provu me mendu obsesivisht për situatën financiare është keq; me mendu për destinacionin e një

udhëtimi është gjë e mirë.

Ironikisht, me e pasë një projekt që ma angazhon intelektin për me punu (si psh me shkru një libër për vëmendjen) tash më shërben si antidotë e shqetësimit mendor. Është një vend ku e qes vëmendjen e jam i vetëm. Ma ofron atë lloj rehatie që më jepete mendimi për statistikat e bejzbollit apo personazhet e librave komikë në kohën e fëmijërisë. Ma ofronte kornizën për një ëndërrim syçelë të strukturuar, ku mendja sillej poshtë e lart me një qëllim.

Me ëndërru me sy çelë është përvojë qendrore e të qenit gjallë dhe po ashtu viktimë e epokës së vëmendjes. Disa vite më parë, dëgjoja podcast derisa ecja. Ndihesha në panik kur s'e bëja. Por derisa po kaloja kohë duke mendu për vëmendjen, e detyrova veten me dalë e me ecë veç me mendimet e mia. Bile i kam zhvilluar do rutina, shprehi e hobi që ma japin kornizën e dëshiruar. Me ça dru, me përgatit pasta, me shku te parku i qenve.

Në vitin 2014, disa psikologë të Universitetit të Virgjinitas dhe Harvardit, vendosën me hulumtu për mënyrën qysh njerëzit përjetojnë bajatësinë. Ata i kishin ulë këta njerëz me një dhomë duke iu thënë mos bëni asgjë për gjashtë deri në 15 minuta dhe më pas i kishin pyet se qysh kishin kalu. E kishin urrejtë. Psikologët më pas e kishin testu sa e madhe ishte ajo urrejtje. A më parë do të bënin diçka të pakëndshme për ta apo do ta kalonin kohë pa bërë asgjë?

Në një studim, pjesëmarrësit kishin pasë mundësi " me përjetu stimulim negativ (shok elektrik) nëse dëshironin," Dhe, qëllojani. "Shumë pjesëmarrës kishin zgjedhë më parë me marrë stimulim negativ se me qëndru pa bërë asgjë – veçanërisht burrat. " Një pjesëmarrës e kishte kalu krejt kohën duke i dhënë vetes shok elektrik, i kishte marrë 190 shoke në atë që ma merr mendja se ishte përpjekje dëshpërimtare me ikë nga vetmia e mendimet e veta.

Mundeni me mendu vetëmevete, "Kjo është çmenduri" ose ndoshta "O, po e shoh veten duke e bërë atë gjë," por shumica prej nesh s'do ta dimë kurrë sepse s'do ta kemi mundësinë që të bëjmë asgjë të zgjedhesh të rënda. Por ndoshta e keni pasë mundësinë me ecë me një kafeteri ku ka rend të madh të pritjes dhe instinktivisht e nxjerrni telefonin veç për me kuptu që e keni harru. Mbetni keq. Ajo çka pason është një dridhje e shkurtë por e fortë e panikut klaustrofobik.

Në një nivel ky është shembull i varësisë që ne e kemi me telefonat tanë, por disa prej nesh që e kemi një farë moshe kujtojmë ndjesi të ngjashme të dikurshme: me shku në tualet pa marrë diçka me lexu, për shembull. Ndërsa gjendja e ndërprerjes së vazhdueshme të vëmendjes mund të jetë e padëshirueshme, rrënjët i ka te një dëshirë më e vjetër se jeta moderne. "Kur shpesh i kisha parasysh shpërqendrimet e ndryshme të burrave," shkruante Blaise Pascal, "kam zbulu që krejt palumtura e burrave vie nga një fakt i vetëm, që s'iu rrihet në vetmi në dhomat e tyre."

Brenga kryesore e Pascalit ishte statusi i shpirtit të burrave. Ai donte me kuptu pse burrat janë aq të tunduar me hy në zaret e luftës, e krejt ato marifete të rrezikshme e mëkatore në vend se me shiju atë që e kanë. Rrënja e kësaj, thoshte ai, është një aspekt i kushtit njerëzor në të cilën varen aq shumë sot: parreshtshmëria e mendjeve tona, lakmia për diçka të re. "Prandaj burrave iu pëlqen aq shumë zhurma dhe

kaosi; prandaj burgu është ndëshkim kaq i tmerrshëm për ta; prandaj kënaqësia e vetmisë është gjë kaq e pakapshme." I jam kthyer goxha shumë Pascalit për këtë çështje shkaku se tingëllon shumë i afërt me ne pavarësisht që ka shkru shumë shekuj më herët.

Kjo lakmi, thoshte ai, na vinte prej një ankthi shpirtëror mbi vdekshmërinë tonë, "varfëria natyrore e kushtit tonë të vdekshëm, aq tmerruese sa asgjë s'mund të na ngushëllojë kur e mendojmë mirë." Aq i fortë është ky ankth sa s'ka pasuri e as pushtet që mund të na mbrojë. Diçka e vërtetë edhe për mbretërit.

Duket se mendja e mbretit duhet me u qetësu, për dallim prej të gjithë të tjerëve në mbretërinë e tij. Mbreti s'duhej me i duru mundimet brutale për mbijetesë. E megjithatë ai farë lehtësimi ishte një lloj tjetër burgu: "Kur e imagjinojmë një mbret që ka çdo kënaqësi të mundshme, nëse mbetet pa zbavitje, dhe lihet me mendu për atë çka është, atëherë ato kënaqësi të dobëta s'kanë me i dalë," shkroi Pascal. "Ai domosdo do t'i hyjë rreziqeve, e evolucioneve që mund të ndodhin, dhe përfundimisht vdekjes e sëmundjes së paevitueshme; kështu që nëse është pa ato që i tërheqin vëmendjen, ai s'është i lumtur, bile më i palumtur se cilido prej subjekteve të tij që e zbavisin."

Bajatësia është diçka edhe më e rëndë se ankesa e një fëmije që s'ka asgjë për të bërë. Mendja e paangazhuar mundet me qenë bishë e egër, dhe shumica e jetës tonë, sipas Pascalit, kalon duke provu me zbutë atë bishë. Kam frikë se të gjithë ne me raste e kemi gjetë veten me mendimet tona në një formë që na bën të ndihemi si një i zënë rob në kafaz me luanin. E sot ne e gjejmë veten në pozitën e mbretit: të rrethuar me burime të pafundme të gjërave që na e tërheqin vëmendjen e megjithatë asgjë e mjaftueshme për me na shpëtëu përnjëmend prej terrorit të bajatësisë.

Kisha dashtë me i ofru disa trika ndihmuese për ju por e vërteta brutale është se as unë vetë s'ia dal aq mirë. Zgjidhja ime është me u siguru që po merrem me gjëra të ndryshme; e drejtoj një emision televiziv dhe një podcast, shkruaj libër dhe i kam tre fëmijë. Kur të afërmit më thonë, "Qysh je?" unë iu përgjigjem instinktivisht, "Mirë! Me punë!" Por, ndoshta zënia me punë është thjesht një përpjekje me shpërqendru veten. Soren Kierkegaardi që shkroi dy shekuj pas Pascalit, tha "Punëtorët më të ngarkuar prej të gjithë të tjerëve, ata që i përngajnë insekteve gumëzhitëse, janë më bajatët prej krejtve." Auç.

Kierkegaardi, si Pascal, e pa bajatësinë si një kërcënim moral dhe bile edhe si "rrënjë të drejtë". Por ai i doli kundër bajatësisë me përtaci, të cilën e shihte si të mirën më të lartë. "Dembelia si e tillë s'është aspak rrënjë drejt; e kundërta, është mënyra hyjnore për me jetu, për aq sa dikush s'bajatoset," – shkroi Kierkegaardi. "Çdo njeri të cilit i mungon vlerësimi për dembelinë tregon se nuk e ka ngritë veten në nivelin e njerëzimit,"

Mendja ime është tepër e zhurmshme që me u ndi rehat me dembelinë e vërtetë. Por çfarëdo që bëjmë në jetë kërkon pak punë, sakrificë dhe qëllim. Mundet me qenë paradoksale me ushtru që me punu më pak, por libri i Jenny Odellit " Qysh të mos bëjmë asgjë " na e ofron një pikë fillimi.

Miliona njerëz falen e meditojnë por edhe bëjnë forma tjera të

praktikimit shpirtëror e psikologjik me të njëjtin qëllim. Ajo çka kanë të përbashkët këto praktika është kultivimi i një disipline të brendshme për me i resizu dëshirës së egër që me zbavitë veten. Kierkegaardi e quajti "princip të limitimit, që është shpëtimi i vetëm në botë... sa më shumë me kufizu veten, aq më i aftë bëhesh."

Po provojmë zgjidhje të ndryshme për këtë problem, që është edhe kurë e re por edhe e vjetër. Ka aplikacione të vëmendshmërisë (mindfulness), ka guru plot që tregojnë qysh me ndihmu veten nëpër Instagram e Tiktok, duke iu premtu qetësimin e mendjes. Këto s'bëjnë shumë me qetësu një popull nervoz, popull i cili është i ndërtuar në atë formë që të bajatavet shpejt prej zbavitjeve konstante. Jemi të ngujuar në paradoksin e mbretit. Po ndjekim çdo zbavitje me egërsi gjithë e më mizore, që mundësohet prej makinave të kontentit që i kemi në xhepat tanë që na bëjnë të kemi nevojë për gjithnjë e më shumë gjëra të cilave ua japim vëmendjen.

Mundemi me imagjinu mbretin e Pascalit derisa iu kërkon oborrarëve me i sjellë argëtime gjithnjë e më ekstreme, perverse e poshtëruese veç sa për me mbajtë interesin e tundimin e tij njësoj si ne në pajisjet që i kemi në xhep, tundim i ngjashëm me atë që e ofron një politikan që e bën interesant, pavarësisht sa mizore apo fyese i duhet të jetë për me marrë vëmendje.

S'mundeni me i ikë bajatësisë me punë apo me zbavitje. As puna e as zbavitja konstante s'është zgjidhje. As për mbretin as për ne. Problemi me të cilin përballemi është ekzistencial dhe shpirtëror, jo rrethanor. S'mundemi me ikë prej mendjes tonë; na ndjek kahdo që shkojmë. Shpresa e vetme është me detyru veten me u largu sado që mundemi. Me u mësu përsëri me qëndru në vetmi.

Ese e botuar në The New York Times . Përkthyer nga Tjetër*

Kosovës po i prishet truri. Punë e madhe!

Nga Tjetër*

“Ballkani prodhon më shumë histori sesa që mundet me konsumim – thotë një fjali monumentale e Winston Churchillit, ish-kryeministër i Britanisë.

Nëse e kufizojmë këtë fjali veç në copën tonë të Ballkanit (Kosovë) dhe 25 vitet e fundit të tranzicionit, atëherë ajo formulohet kështu: “Kosova prodhon më shumë lajme portalesh sesa që mundet me konsumim,”

Rrethana e të parëve tanë që përshkruhet me aq kollajllëk prej Churchillit është e shkuar-e-harruar tashmë. Fabrikat e prodhimit të historisë i kemi prishë! Jemi zbutë prej politikave të imponuara nga BE-ja. Dikush mund të thotë “ mirë që ndodhi kështu”, tjetër kush që “hej, ne veç trojet tona i kemi mbrojtë”. Etj. Por, s’po i rrekemi këtij diskutimi. E vërteta është që s’po prodhojmë më histori çdo të dytën ditë.

E megjithatë, lajmet e portaleve janë aq të shumta sa ta nxisin idenë se ndoshta ende jemi ata ballkanasit e asaj thënies së Churchillit. Por jo! Ato janë thjesht iluzioni optik që na duhet për me jetu rehat me veten.

Dikush mund të thotë që portalet bëjnë tituj senzacionalë sepse duan të gjenerojnë klikime e shikime e përmes tyre para. Ne besojmë që e bëjnë sepse i thërret historia. E bëjnë sepse ndryjnë në vete atëfarë lozën e të parëve për krijim të historisë. Nëse jo, çka bëjnë gjithë ata kosovarë që lexojnë aq shumë lajme në ditë?! Ose ata që rrinë para televizorëve duke i përcjell tri-katër palë lajme në ditë?! Është zakon që vjen indirekt prej stërgjyshërve të cilëve lajmi për Luftën e II Botërore iu vinte mes llafesh tjera për bagëti e bujqësi. Qe një shembull nga një llaf mes dy fshatarëve shqiptarë në vitin 1940:

“A i keni gati arat për sivjet?” – Filani.

“Gati bre gati. Po, na kanë lodhë na kanë terë. By the way, po flitet që ka nis Lufta e Dynjasë.” – Fisteku.

“Vallahi, le të nis po punët e arave s’na i kryen kurrkush.” – Filani.

“Po, po. Edhe ashtu, na jemi mësu. Bile po thonë që kjo asht Lufta e Dytë e Dynjasë.” – Fisteku.

“E dyta? E ku kem na kur ndodhi e para, jashtë dynjasë a?” – Filani.”

Tash, kosovarët modernë kërkojnë lajmin për Luftën e III Botërore edhe nëpër artikuj showbizi. Qe 25 vjet. Qe çerekshekulli.

E kohët e fundit – meqë kemi konsumim për çerekshekulli lajme triviale – ka nis e po na manifestohet një farë efekti psikologjik kolektiv. Po na prishet truri.

“Brain rot” (prishja/kalbja e trurit) u shpall fjala e vitit

2024 prej Oxfordit. Hairi e ndaftë! Ajo definohet si “përkeqësimi i gjendjes intelektuale apo mentale të një personi, që shihet të jetë si rezultat i mbikonsumimit të materialeve që konsiderohen triviale apo jofiduese.” Pra, një prishje truri që vjen kur han tepër shumë kontent të cilësisë së dobët.

“E çka lidhet Oksfordi me neve, allahile?” – mund të pyes ndonjë cinik. Në mënyrë jocinike mund t’ia kthejmë cinikut me kundërpjetje: “A dini ndonjë vend tjetër në botë ku cilësia e kontentit online është më e dobët ndërsa konsumi i saj aq i madh se në vendin tonë?!”

Qysh po na manifestohet prishja e trurit?! Qe do shembuj:

“Kosova mundet ma mirë!” – është slogani i një partie të opozitës. Duket si fjali e thënë prej dikujt që është nën kërcënimin e tytës së armës nga dikush që i thotë i ke pesë sekonda kohë për me formulu një kritikë ndaj pushtetit.

“Cep më cep!” – është slogani i partisë në pushtet. Duket si fjali e thënë prej dikujt që është nën kërcënimin e tytës së armës nga dikush që i thotë i ke katër sekonda kohë për me formulu një fjali për lavdërim për veten.

S’po hymë te tjerat.

Një prishje tjetër e trurit na shpërfaqet edhe në aktivitetin politik. Më të zëshëm, më kreativë e më të vërtetë duken profilet e rrejtshme të Fejsbukut që e kanë mbipopullu debatin publik se sa simpatizantët e vërtetë, e bile edhe se sa politikanët e vërtetë. Mos të flasim për njerëzit e vërtetë të Kosovës, të cilët s’e dimë as qysh duken.

Tjetër* do të funksionojë si një hapësirë ‘tretëse’ për hapësirën publike. Pra, do të ndihmojmë që konsumi i lajmeve të bëhet përmes një farë tretjeje më të shëndetshme!

E kështu me radhë. Kosova mundet ‘ma’ mirë! E të tjera!

Shfaqja horror e djalit të Trumpit me Vuçiqin në Beograd

Nga Tjetër*

Një sharlatan udhëtoi drejt Beogradit para pak ditëve me ndihmë Aleksandër Vuçiqin me dalë prej situatës ku ndodhet. Sharlatani quhej Donald Trump i Vogël. Pra, i biri i presidentit amerikan Donald Trump. Ai i bëri një intervistë presidentit serb duke tingëllu si gazetar i dobët i Sputnikut të Rusisë. Ose edhe më keq se kaq.

Sharlatani në fjalë e konsideron Kosovën tonë “rajon të Serbisë” pa pikën e gajles. Për intervistën me Vuçiqin thotë se ia çeli sytë dhe e fascinoi. E lavdëron këtë shtet që po i del zot sovranitetit dhe kufijve.

S’rresht së thëni fjali që nisin ose mbarojnë me “përnjëmend” (actually) apo “bukfalisht” (literally) si një tinxher i llastuar që hiperbolizon çkado që thotë.

“Nato përnjëmend e ka bombarduuu Serbinë,” – thotë Trumpi i vogël duke u mundu me alarmu audiencën. Ai iu doli kundër këtyre bombardimeve duke i lidhur ato disi me aferën seksuale të Bill Clintonit (presidenti i asokohshëm), siç edhe mund të pritej nga një zagar i propagandës ruse.

Me Vuçiqin kundër studentëve

Trumpi i vogël denoncon protestat studentore në Serbi qysh në prolog.

“Folëm edhe për protestat që i keni parë në Beograd. Jam i sigurt se mediat do ta raportojnë veç njërën anë. Dhe tash, ka si duket edhe prova që krejt lidhet në ndonjë formë me të njëjtët akterë të të majtës këtu në Amerikë. Me atë makinë propagande. Bile edhe me disa lidhje me USAID-in. I shokuar që e dëgjova këtë gjë, djema. I shokuar.” – shprehet sharlatani.

S’ka prova. S’ka kurrgjë. Ka thjesht përsëritje të disa dyshimeve as që provon me i verifiku.

“Po iu ofrojnë fëmijëve nga 100 euro për me dalë në protesta... pastaj një profil i rremë në mediat sociale e një gruaje të bukur që të noton me 10-she nëse del në protestë... Kësisoj, fëmijët dalin në protesta e s’e dinë as çka janë,” – thotë Trumpi i vogël.

Pra, ndaluni pak këtu. Djali i presidentit amerikan po ndërhyt haptas në dinamikat e brendshme të një shteti. Po e ndihmon haptas Vuçiqin. Po bën propagandë kundër studentëve që duan rrëzimin e tij.

E bën Vuçiqin të duket... modest

Përmes qasjes së tij tejthjeshtuese politike, Donald Trumpi i Vogël ia lehtoi punën Vuçiqit. Në fakt, e bëri të dukej edhe modest.

Kjo ra në sy veçanërisht derisa po përgojonin Bashkimin

Evropian. Sulmet e Trumpit të Vogël ishin bizare. Vuçiqi ia niste pak, e pastaj ndalej.

Shihni me çfarë fjalësh sulmon presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskiy:

“Zelenskiy ndoshta po i vjedhë paret (e luftës). .. të paktën ky është mendimi im. E di që s’mund ta thuash se e ke mik ama...”

Kjo e la të ngrirë edhe keqbërësin Vuçiq që s’dinte çka të thoshte.

Vuçiqi – i kundërti me Zelenskiyn

Trumpi i vogël e pyeti presidentin serb edhe për takimin e fjalosjes së ashpër mes presidentit Trump dhe Zelenskiyt.

Këtu mund ta shihni qysh Vuçiqi ulet në dy karrige, në të njëjtën kohë.

Në një anë, ai thotë se Zelenskiy kishte vepru mençur sepse duke e kundërshtu Trumpin e kishte rritë popullaritetin në Ukrainë (që sipas tij po i binte). Por në tjetrën, ai e quan veprimin e Zelenskiyt të pamënçur. Pra, edhe i mençur edhe i pamënçur. Edhe i mirë, edhe i keq.

Ai e tregon një storie personale.

“Duhet me kuptu pozitën tënde. Me kuptu që s’je i barabartë me Trumpin,” – ia nis Vuçiqi meseles me Trumpin e vogël që kënaqet krejt.

“Njerëzia këtu (në Serbi) më kritikonin sepse kur isha në atë Zyre Ovale, Donald i solli – ose stafi i tij dikush – një karrige të vogël për mua sa kjo. Dhe dukësia si fëmijë. Ai e kishte atë karrigen e madhe. Dukej si mbret i ulur ndanë meje. E njerëzia më thoshin se na e more fytyrën. Dhe unë kisha mendu. I thashë vetes: “hej, hej, ky është Donald Trumpi. Ky është presidenti i Amerikës. Ose ulu, ose shtriju ose bëj çka të duash. Por respektoje Trumpin dhe lufto për popullin tënd.” – tha presidenti serb.

Ai më pas tregoi se ishte goditur edhe nga Rusia për atë karrige. Por, atij s’i bënte. Vuçiqi e kishte fjalën për takimin e famshëm të Washingtonit kur ishte me Avdullah Hotin në Zyre Ovale.

E derisa Vuçiqi tregonte, Trumpi i vogël kënaqej.

A është Amerika ende vend mik i Kosovës? Nëse presidenti amerikan mendon veç sa çereku i djalit të tij për Vuçiqin... atëherë jo.

Malli për Hashim Thaçin dhe plakja e tij ‘u krijuan’ nga algoritmat e Facebook-ut

Nga Tjetër*

Ngjarja më e bujshme e javës ishte vizita e Hashim Thaçit në Prishtinë për me taku babën e sëmurë.

Në vetëvete s’kishte kurrfarë rëndësie. Thaçi po e bënte një vizitë private. S’do të ndërronte kurgjë hiç në rrethanat tona. Por, ja që algoritmat e Facebook-ut – ku llogaritë e rreme e bëjnë namin – krijuan artificialisht idenë se diçka po ngjante. Dhe kështu lindi ‘ngjarja’.

Hashim Thaçi ishte në Kosovë pas më shumë se katër vitesh. Por, Thaçi s’mund të fliste e as vizita s’kishte ndonjë rëndësi për publikun... u prodhuan artificialisht lajme.

Lajmëtarët u morën me pamjen e tij të jashtme. Thanë se ai ishte rrudhë e ishte thinjë e ishte plakë; se i kishte marrë malli. Filluan t’i krahasojnë fotografitë e Thaçit nga viti 2020 dhe 2025.

Të mallëngjyerit harruan krejt që ai na shfaqej nëpër media gati çdo javë i ulur në ndjekje të seancave gjyqësore në Speciale. Ai dukej bash ashtu siç dukej në ato seanca. Të njëjtat rrudha, të njëjtat thinja, po ajo plakje. Nëse kishin pasë mall, mund ta kishin pa aty.

Qe ku është para një muaji. Po dëshmonte Imer Imeri, në një nga seancat më të rëndësishme ndonjëherë. Shihni numrin e shikimeve në verisonin në gjuhën shqipe: veç 97 vetë.

Seancat tjera kanë edhe më pak. Ku janë të mallëngjyerit?

Nejse. Më pas u morën me posturën e ish-presidentit. Thaçi po mbahej i fortë por dukej i thyer?! E kishte mundu burgu por s’po ia linte shenjë?!

Më pas, meqë Thaçi s’po fliste. Meqë s’po ndodhte asgjë, u kërkua të fliste për atë vizitë kryeministri Albin Kurti me presidenten Vjosa Osmani. E çka të thoshin?

Mos ndoshta e gjithë çështja ishte thjesht t’i merrnin do pëlqime? Ne besojmë që po.

TJETËR* është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

Pse shtetet s'po luftojnë më si përpara?!

Nga Tjetër*

Gazetari me nam të madh në YouTube, Johnny Harris, e ka publikuar të enjten (27 mars) një video me titull "Mënyra e Re qysh shtetet po e luftojnë njëra-tjetrën (dhe pse kjo ka rëndësi)".

Ashtu qysh ndodh me gati secilën video të tij, edhe kjo u bë virale. Çka thotë aty Harris?

Që në nisje, na i prezanton nja dy tri grafe mjaft domethënëse.

Te grafi i parë i keni luftërat mes shteteve.

Te grafi i dytë i keni luftërat mes shteteve dhe luftërat civile.

Dhe tërërm. Ose BOOM. Te grafi i treti i keni luftërat proksi. Shiheni çfarë rritje e jashtëzakonshme e tyre prej vitit 2010 e deri tash.

Drithëruese, apo jo?!

Qysh mundeni me ditë plot prej jush, pas Luftës së Dytë Botërore superfuqitë u bënë me armë bërthamore. Dhe kjo i ndaloi ato që të luftornin direkt me njëra-tjetrën. Sepse, po të luftonin direkt atëherë do të bëhej e zezë dita. E do të bëhej vera dimër (jo si me shtëpizat palidhje në shesh por si dimri nuklear). Bukfalisht kështu. Sepse, do të shkatërrohej bota siç e njohim.

Për me evitu luftën direkte, ato e bënë fushëbetëjë krejt dynjanë.

Johnny Harris e merr shembull historinë e Koresë. Luftën proksi mes Amerikës dhe Bashkimit Sovietik në atë gadishull, që çoi në ndarjen e dhimbshme në dy shtete. Kore të Jugut dhe të Veriut respektivisht.

"Dhe këtu shohim diçka të çmendur që do ta shohim goxha shumë në këto luftëra proksi. Edhe kur Korea e Veriut donte ta ndalte luftën, Moska s'e lejonte." – na rikujton Harris.

"Le të digjet një komb i tërë, veç që ta turpërosh kundërshtarit tënd." – është filozofi udhëheqëse.

Harris flet me Jeremy Shapiron, një ekspert të marrëdhënieve ndërkombëtare, për me zbërthi më mirë këtë farë teme. Më specifikisht, pse po rritet numri i luftërave proksi?!

"Çështja (pse janë rritë luftërat proksi) është se ka shumë më shumë lojtarë." – tha Shapiro.

Ana e dhimbshme e gjithë kësaj është se lufta proksi shpesh është edhe më e dhimbshme se lufta direkte. Pse? Sepse mund të jetë më e gjatë dhe më vdekjeprurëse shkak i armatimeve që s'ndalen prej superfuqive për grupet lokale.

Çka është puna e Ukrainës?! Pse është luftë kaq e rrezikshme. Lexojini këto fjalë.

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

"Ukraina është luftë gjysëm-proksi. Prandaj, është e rrezikshme. Sepse, njëra fuqi nukleare është tepër e përfshirë, dhe beson fuqishëm se rezultati i luftës ka rëndësi ekzistenciale për ta. Por, qëndrimi i Rusisë – ... – nënkupton se mundësia që të kemi eskalim përtej kontekstit të luftës proksi është tepër e madhe." – rrëfen eksperti në fjalë.

Sipas Harrisit, e vetmja superfuqi që nuk përzihet në luftën proksi është Kina. Hmmm, e çuditshme.

Nejse, ajo çka mundet me i interesu dikujt prej Kosove në këtë pikë është: a ishte edhe lufta e Kosovës proksi?

Deri më 24 mars 1999, ndoshta po. Por, pastaj jo. Deri në ditën kur intervenoi NATO kishim luftën mes UÇK-së dhe ushtrisë së Jugosllavisë. Pra, ishte luftë civile. Në një anë ishte Amerika me shtetet tjera anëtare të NATO-s. Në tjetrën Serbia, Rusia dhe do shtete të ngjashme. Por, më pas NATO intervenoi direkt ushtarakisht për me ndërru krejtësisht natyrën e konfliktit. Dhe u bë, gjysëm-proksi siç e quan Shapiro konfliktin në Ukrainë.

Ndoshta për atë arsye Putini është i fiksuar me Kosovën?!

Video e plotë:

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

Poshtërimi publik i Baton Haxhiut për zbavitje personale

Nga Tjetër*

Tash e një kohë të gjatë, shumë të gjatë, televizionet e Kosovës po iu përngajnë katastrofave natyrore . Ndodhin. E ti s'ke fuqi as t'i ndalësh, as t'i kuptimësosh, as t'i pranosh, as t'i mohosh. Të kaplon absurdi dhe të hidhet të protestosh. Por, ndaj kujt? Ka veç një adresë proteste për katastrofa natyrore. E allahu s'ka email.

S'po moralizojmë. Absurdja e pamundëson moralizimin. Është përtej saj.

Një skenë e tillë absurde që na ligështoi u shfaq në emisionin Pressing në T7 të martën më 1 prill. Zgjati saktë një minutë e tre sekonda.

Dukagjin Gorani e Ilir Mirena ishin ulur në një anë. Leonard Kërçuki në mes. Baton Haxhiu në tjetrën anë. Secili kundërshtar më i madh i kryeministrit Albin Kurti se tjetri. Paragjyqeshëm, këta janë edhe shokë të njëri-tjetrit. Prandaj, s'pritej të kishte ndonjë fërkim. Por, ja që natyra njerëzore është ajo që është.

Gjithçka nisi në minutën 42:36 .

E gjithë atmosfera ishte e relaksuar. Së tepërmi e rekalsuar. Skenari s'kishte pikë pushteti. As moderatori Kërçuki. As kamerat. Njëpërdukej ajo që është sepse ekziston, dhe ajo që s'është sepse s'ekziston.

Sus.

"Nuk na ndihmon nëse i qujmë imbecila," – tha Baton Haxhiu pa të keq, duke iu referuar një fjalie të mëparshme të thënë nga Ilir Mirena ndaj opozitës.

"E çkafi na ndihmon, Baton ?" – e pyeti me tallje Dukagjin Gorani. Toni i tij ishte aq cinik sa e nxiti menjëherësh një qeshje poshtëruese si nga Ilir Mirena, si nga moderatori Leonard Kërçuki. Shihni fytyrën e tij:

"Na dut mu ballafaqu me qit realitet," – argumentonte Batoni. "Dut mu ballafaqu me qit realitet."

"Na mu ballafaqu hiç, po ata. " – ia ktheu mendjemadhësisht Gorani i përcjellur nga Mirena haptazi tallës "Ata more, se na s'kem edhe përgjegjësi Baton,"

Batoni provoi të dilte nga situata, duke thënë:

"...koha jonë shkon, gjithashtu..."

"Shkon edhe e tyne," – i ndërhyu sërish Gorani, me tonin ngadhënjimtar të dikujt që e kishte nën kontroll të plotë kundërshtarin.

Çka po ndodhte? Pse po poshtërohej kështu Baton Haxhiu nga Dukagjin Gorani e Ilir Mirena? Me shumë gjasë këtë pyetje e

kishte edhe vetë Batoni. Dukej i dërrmuar, i humbur, i pezmatuar.

E vuajtja e tij po rritej e po rritej, me përpjekjen për të dalë nga situata që e bënte të dukej gjithnjë e më idiot. Batoni s'tha asgjë idiote, por u trajtua për hesap të zbavitjes personale sikur kishte thënë diçka ekstremisht idiote nga Gorani e Mirena. Dhe, nisi të rrëshqiste më poshtë e më poshtë. Prisni.

43:12

"E para. Ata s'e kanë informatën për veten." – tha Baton Haxhiu më pas.

"Paramendo qet fjali : s'e kanë informatën për veten." – tha Dukagjin Gorani, me Ilir Mirenën që u shfrenua duke qeshë.

Pauzë. Pauzë. Duhet me pranë që ajo çka tha Baton Haxhiu s'ishte fjalia më e mençur në botë. Por, s'ishte as kushedi çfarë budallallëku që meritonte të poshtërohej kështu.

43:21

"Cilën informatë s'e kanë për veten?" – vazhdoi poshtërimin Gorani.

"Se çfarë bojnë me partinë... ose çfarë... po flas për partinë... s'e kanë inf... partia nuk e ka informatën çka ka me bo me veten..." – u mundua të shpjegohej Baton Haxhiu.

"Po mendon nuk ka informacione? – i tha Dukagjin Gorani.

"Jo jo," – Batoni.

"Po mendon nuk e dinë..." – e korrigjoi Iliri.

"Nuk e dinë," – u dorëzua Batoni.

Baton Haxhiu nuk është folësi më i shkathtë publik. Por, siç mund ta shihni nga pjesa e mësipërme, ai s'tha kushedi çfarë budallallëku që ta meritonte gjithë atë bullizim nga Dukagjin Gorani e Ilir Mirena. Folës aq të shkathtë s'janë as dyshja Gorani e Mirena. E s'është as moderatori Kërçuki.

Pse ndodhi kjo? Pse ndodhin cunamit, tërmetet?

TJETËR është një faqe që funksionon në baza vullnetare. Mbështet punën tonë duke pëlqyer faqen tonë në Facebook (KËTU) dhe kanalin tonë në YouTube (KËTU).

Jooooo: Miliarderit të parë shqiptar në Forbes i dalin lidhjet me Serbinë

Nga Tjetër*

Mediat që sponsorizohen nga biznese të Samir Manes, e bënë të Millosheviqit".

madhe javën që shkoi lajmin se një shqiptar ishte futur në listën e miliarderëve të revistës prestigjioze Forbes. Kush ishte ai farë burri? Surprizë: ishte Samir Mane. Por, Forbes në serbisht – pa të keq – ia përmend edhe lidhjet e tij me Serbinë.

Artikulli i përgatitur nga Jellena Andriqi titullohet “Kush është shqiptari Samir Mane nga lista Forbes e miliarderëve: Biznesi me Mishkoviqin dhe lidhjet aktuale me Serbinë”

Por, s’e jep megjithatë atë që e premtun. T’i themi së pari disa gjëra që janë të rëndësishme të dihen.

Pasuria e z. Mane vlerësohet të jetë rreth 1.4 miliard dollarë . Sipas Forbesit, ai është themelues dhe president i Balfin Group, një kompani që punon në patundshmëri, elektronikë, tregti me pakicë dhe banka. Ka qendra tregtare, dyqane të gjërave elektronike e të lojërave në mbarë Ballkanin Perëndimor. Ka patundshmëri edhe në ShBA, Kanada e Austri.

I ra kah Beogradi

Ajo çka i bie në sy Andriqit nga biografia e ofruar në Forbes për Manen është fakti se iku nga regjimi komunist i Shqipërisë në vitin 1991 për në Austri. Në këtë vend kishte shkuar duke shkelë së pari Beogradin. E kah t’i binte i ngrati?

Në vitin 1993 u kthye në Shqipëri dhe nisi të shiste gjëra shtëpiake. Pak më vonë e hapi edhe një zinxhir dyqanesh për gjëra elektronike.

“Një fakt interesant nga biografia e tij është që ai fjeti në kamion gjatë udhëtimit dyditor prej Vjenës në Shqipëri, ku ia nisi të shiste gjëra shtëpiake.”

Biznese në 11 shtete

Më tutje, informohemi se kompania e tij operon në 11 shtete: Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnje, Maqedoni të Veriut, Kroaci, Zvicër, Mal të Zi, Holandë, ShBA dhe Kanada. Ku është Serbia? – e pyetëm Forbesin nga përtej ekranit (hint: ishte pak më poshtë):

“Me dy shokë të mi, e para dyqanin e parë privat në Shqipëri më 1987. Shisnim qebapa,” – tha z. Mane njëherë në Top Albania Radio, siç e citon Forbesi.

Puna me Miroslav Mishkoviqin

Eh, këtu flen lepurit (e jo në kamionin që shkon prej Vjene në Tiranë me shporetë e me enëlarëse) Miliarderi shqiptar që doli në Forbes bashkëpunoi edhe me biznese serbe. Në rend të parë, me kompaninë e oligarkut serb Miroslav Mishkoviqin.

Gazeta Tema e cilësonte Mishkoviqin si “eksponent të Sllobodan

Qysh bashkëpunoi? Nga ajo që dihet publikisht dhe që s’mund të mohohet, është e mëposhtmja:

Në vitin 2005, kompania e tij Balfin Group e kishte hapur zinxhirin e parë të madh të supermarketeve në Shqipëri të quajtur Euromax. Pas diku tre vitesh, Mane e kishte shitur Euromaxin te kompania serbe Delta.

Por, lidhjet e Manes me bizneset serbe s’ndalen këtu. Ai bashkëpunoi edhe me kompaninë serbe Milshped , me të cilën kanë themeluar dy kompani së bashku.

A të krenohemi me Manen që hyri në Forbes?

Bullizmi ndaj Agim Bahtirit është bërë i tepërt

Nga Jetlir Buja

Një ditë prej ditësh ma vodhi vëmendjen një shkrim. Ishte i gjithi i mbushur me lajlelule. Fjalët s'e kryenin as funksionin bazë në fjali sepse ishin shndërru në zbulurime koti. Krejt ajo çka shkrimi thoshte mund të përmbledhej kollaj me një fjali të vetme, të shkurtër sa titulli. Por, ja që autorit i duhej gjithë ai sinonimizim sepse vetëm ashtu i gjente përmbushje supremacia mes këtij mileti analfabetësh funksionalë.

Këtu na futet Agim Bahtiri. Ashiqare, Agimi s'e ka hallin që t'i lë përshtypje dikujt me fjalor e me simbolika. Bile, edhe ato fjalë që i di nganjëherë i shqipton dallash kur ngutet. Mirëpo, kryen punë. E kupton se kur thotë diçka e ka përnjëmend, prandaj edhe arrin me shprehë emocion e me qenie bindës. S'merret me lajlelule. S'ka vakt.

Përqeshja e 10 prillit

Po i grahja me gisht teposhtë newsfeed- it në Facebook kur pashë fytyrën e Agim Bahtirit. I ngrati ishte bërë sërish objekt i përqeshjes masive. I qeshur po e përshëndeste dikë. S'po ma rrokte se ku ishte problemi?! Grimasat e fytyrës i kishte të natyrshme për dikë që gëzohet kur e sheh dikë tjetër. S'po bënte ndonjë huqje. As ndonjë keqshqiptim. Asgjë.

Pse po bullizohej?

Arsyeja besoj se qëndron te një pasojë që ka shkaktuar përqeshja masive e bërë tash e mbi një dekadë. Kjo përqeshje është bërë aq hysterike sa sot njerëzit janë të predispozuar që të qeshin me Agim Bahtirin edhe kur bën gjestet më të natyrshme e të rëndomta njerëzore. Po e përshëndeste dikë, në këtë rast. Por, në parakuptimet e përqeshësve surrati i Bahtirit po thoshte diçka me të cilën duhej të shkriheshe së qeshuri. " Qysh bre s'pe kupton?! Fundja, pse mos me qeshë? Po qeshin të gjithë." – mund të thoshte i pashëri bullizues kur i kërkohet me i gjetë arsyet. Prandaj meqë të gjithë po qeshin – mendon ai – duhet me pasë një arsye.

Siç e thamë, këta njerëz janë të predispozuar që të qeshin me Agim Bahtirin. Dhe janë të predispozuar sepse ky personalitet është përqeshur kolektivisht aq brutalisht sa kjo mbërriti masën e dehumanizimit . Shtypeni në YouTube emrin e tij dhe shihni çfarë sugjerimesh iu dalin. Ose kudo tjetër.

Provoni me mendu si qenie njerëzore Agim Bahtirin. Si dikë që të paktën një herë në dhjetë vjet e meriton të trajtohet në mënyrë njerëzore. Dhe pastaj pyeteni veten: s'është trajtimi ndaj tij abuziv? A s'janë trajtuesit abuzivë si nxënës bullizues të fillores?

Eh, këtu duam të dalim.

Anatomia e këtij budallallëku

Shikojeni mirë legjislaturën e kaluar të Kuvendit të Kosovës. Mund t'i gjeni veç një a dy përfaqësues të shtresës së mesme të

ulët. Për varfanjakë, harrojeni . S'ka. Dhe, s'do të ketë as në të renë.

A ka mes nesh njerëz të varfër? Natyrisht se po. Kahmos. Por, qytetarit të Kosovës i është thënë që prej nisjes së këtij tranzicioni të pafundmë socioekonomik që ta përçmojë veten . Dhe ai ka pranuar. Prandaj, kosovari i rëndomtë jo veç që s'mund ta durojë një përfaqësim të situatës së tij socioekonomike, por s'mund ta durojë as përfaqësimin e situatës së tij kulturore. Situatat më të rehatshme për të, janë ato më tëhuajueset.

Shihni me çfarë shpejtësie të rrufeshme u zhdukën prej rrugëve polisat, kapuçat e zinj dhe teshat tjera të gjyshërve tanë. Me po atë shpejtësi po na zhduket edhe fjalori i tyre. Dhe me po atë shpejtësi do të na zhduket njerëzillëku, duke na lënë si zombi që hanë njëri tjetrin. Snobët do të hedhin valle!

Kjo është perspektivë e rëndësishme për me kuptu (deridiku) trajtimin kolektiv ndaj Agim Bahtirit sepse të shtypurit në Kosovë s'do të përfaqësohen prej personazheve që paraqesin fshatarësinë e varfër në filmat e Kinostudios Shqipëria e Re.

Por, t'i përjashtojmë shtresat e shtypura për një moment. Cili është formimi kulturor i një qytetari të rëndomtë të Kosovës? S'është i afërt me të Albin Kurtit. Është i afërt me formimin kulturor të Agim Bahtirit. Njerëzit i bashkohen përqeshjes kolektive për Agim Bahtirin – janë të predispozuar që ta përqeshin – sepse e njohin intimisht. E bullizojnë Agim Bahtirin sepse kanë përbuzje të thellë për veten. Dhe më besoni, s'po e them këtë gjë me idenë se këta janë të padijshëm ose s'dinë të flasin ose kështu diçka. Po e them sepse kështu është. Bile, edhe Agim Bahtiri e përçmon Agim Bahtirin. Shihni se si shkruan në Facebook. Qartazi, ai e paguan një lajlelul koti për t'i qëndisur statuset e tij.

Dikush mund të thotë: e gjithë kjo përqeshje e gjaaaatë ndaj Agim Bahtirit ndoshta ka thjesht motive partiake. Ka edhe motive partiake. Por, jo veç motive partiake. Glauk Konjufca praktikisht e përçafonte portretin e ndërtuar për Agim Bahtirin nga bullizuesit e tij si njeri të padijshëm kur në Mitrovicë e quajti me tallje akademik.

E gjithë kjo frymë përjashtuese mund të kuptohej deridiku nëse Agim Bahtiri do të ishte senzacion i para dy javëve. Ose hajt, para dy muajve. Por, Agim Bahtiri është në skenën politike qe dymbëdhjetë vjet. Po bullizohet qe dymbëdhjetë vjet.

Qysh ka mundësi që të paktën të mos bëhej bajat krejt kjo?!

Përveç kësaj, a jemi rehat me kulturën dhe edukatën që po përçojmë përmes këtij bullizimi të egër shumëvjeçar? Sidomos me rastet kur s'kemi kurrfarë lënde për përqeshje – a s'rezikon kjo të na çojë drejt legjitimitit të përqeshjeve të njerëzve për anomali në të folur, për pamje të jashtme etj?

Kur grandioziteti i Kurtit kthehet në krizë institucionale

Nga Tjetër*

Shkruan: Gazmend Demolli

Që në start, hajde ta sqarojmë një gjë: “Kryeministër në Detyrë” është titulli për një kryeministër në fuqi të plotë, me gjithë shkëlqimin e pushtetit. “Ushtrues i Detyrës”, nga ana tjetër, përdoret për periudhën kalimtare pas përfundimit të mandatit deri te dorëzimi i detyrës.

I shfletova dokumentet zyrtare të Republikës së Shqipërisë për të konfirmuar atë që për mua ishte e natyrshme, sepse, siç duket, në gjuhën që po përdoret në Kosovë ka një konfuzion të madh dhe, si rrjedhojë, një mini-krizë teatrale në Prishtinë. Nëse për asgjë tjetër, sigurisht se për çështje gjuhësore, konsultimi i teksteve në Shqipëri na ndihmon.

Kurti ka një tendencë grandioziteti në sjelljet dhe gjuhën e tij. Kjo prirje për të fryrë, zbukuruar arritjet, për të ekzagjeruar qëndrimet, të bëmat. Por edhe titujt. Sikur brucoshët në LinkedIn që, në mungesë të përvojave të vërteta, shpikin terma për t’u dukur më interesantë. Teknik i Lartë i Mirëmbajtjes, kur në fakt është thjesht pastrues.

Por grandioziteti i Kurtit nuk ia pranonte vetëvetes termin “ushtrues detyre” ose “në dorëheqje”. Sepse Kurti nuk pranon të jetë më pak se i plotfuqishëm. Nuk pranon të jetë ushtrues detyre. Interesante se si as në gjuhën e folur shqipe nuk përdoret fjala “njerë”, që do të thotë burri i nanës, një lloj ushtrues detyre i babës.

Zakonisht, mbiemri “në detyrë” i shtohet një titulli vetëm atëherë kur duam të theksojmë karakterin e tij të plotfuqishëm, krahas ushtruesit të detyrës, që shpesh ka kompetenca më të kufizuara. E dëgjojmë shpesh si “ushtrues detyre i drejtorit” ose “u.d. i Kryeprokurorit”.

Kjo, megjithatë, do të mund të kalonte si një ves i keq, nëse nuk do të bëhej mollë sherri institucionale në konstituimin e Kuvendit të Kosovës.

Neni 26. Në rast se një anëtar i Qeverisë në detyrë zgjidhet deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i njëjti duhet të japë dorëheqje nga posti i anëtarit të Qeverisë para ditës së certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve.

Kjo u lexua nga të gjithë si kërkesë ligjore edhe për ushtruesit e detyrës, kur në fakt specifikisht thuhet “në detyrë”. Kap njërin, mëshoj tjetrit. Nga Enver Hasani e deri te Presidentja Osmani, duke kaluar nga të gjithë deputetët, partitë politike, juristët, analistët, komentatorët.

Kurti dhe anëtarët e tjerë të Qeverisë, si sponsorë të këtij ligji, me kot e thonë se kjo ka kuptim tjetër. Se nuk duhet të ketë vakum qeverisës. Me kot, sepse konfuzioni vjen nga vet dëshira grandioze e Kurtit për t’u quajtur “në detyrë”. Në krye

të detyrës.

Nëse keni ndonjë dyshim, lexoni ligjin në anglisht, aty thuhet “incumbent member”. Kjo nuk lë asnjë dyshim se bëhet fjalë për ministrat në detyrë të plotë, dhe asnjëherë për ushtruesit e detyrës.

Por hajde në mujshi, shtyjeni Kurtin t’i thotë vetes Ushtrues Detyre!

Kur ishte zhvillimi i fundit politik në Kosovë?

Nga Jetlir Buja

Rritja e çmimit të vezëve ishte më e rëndësishme si çështje për votuesit amerikanë sesa rreziku që po i kanosej demokracisë 250-vjeçare të tyre.

Donald Trumpit – miliarderi skandaloz që u bë president – iu desh të shfaqej në fushatë para produkteve ushqimore për ta bërë më sensacionale rritjen e çmimeve.

Ndikimi në çmime të produkteve ushqimore vazhdon të përcillet me shumë vëmendje nga mediat amerikane edhe sot sepse është lidhur direkt me popullaritetin e presidentit. Dhe pikërisht pamundësia e Trumpit që si president t'i ulte çmimet e ushqimeve brenda 100 ditëve të para i dha atij goditjen më të madhe politike deri tash pasi i vendosi tarifa krejt botës. Nuk ishin skandalet e tjera të tij. Nuk ishte as kriza kushtetuese. Ishte çmimi i vezëve dhe produkteve tjera që e goditi popullaritetin e Trumpit.

Në Kosovë, ndërkohë, rritja e çmimeve të plot produkteve vazhdon të ndodhë e papenguar nga ndonjë mbikëqyrje shtetërore a nga ndonjë kontestim publik. Dikush e bën një kukamë si kjo nëpër media sociale, dhe pastaj secili i rikthehet punëve të veta. Po politika? Eh, në këtë pikë duhet me u ndalë.

Dështimi i dhjetë për konstituimin e Kuvendit të Kosovës besoj se po ekspozon partitë politike në Kosovë thjesht dhe vetëm si grupe interesash private që ndodhen përbrenda një grindjeje private. Preokupimi i tyre s'është dhe s'ka qenë asnjëherë qytetari i varfëruar i Kosovës nga rritja e çmimeve. Nga një ekonomi që s'e përkthen rritjen e saj në mirëqenie të qytetarit. Preokupimi i tyre ishte dhe mbeti emri i kryekuvendarit, kryeministrit, ministrave.

Logjika thotë se sikur dikush prej liderëve të partive politike ta kishte ndonjë zgjidhje për çfarëdo problemi, atëherë do të bënte marrëveshje politike që të ecej para. Sepse, përveç që do të donte të zgjidhej ai problem edhe do të merrte popullaritet të madh. Por, s'ka.

Kosova si shtet vazhdon të humbë edhe betejat me problemet më minore: lufta me qentë endacakë; lufta me bërlllokun; lufta me pirjen e duhanit brenda ambienteve të mbyllura; lufta me ajrin e ndotur; lufta kundër betonit. Natyrisht, e humbur që në nisje ishte dhe mbeti edhe lufta me tregtarët abuzivë që na i rrisin çmimet.

Kosova s'është në krizë kushtetuese. Është në krizë mentale. Meqë mungojnë politikat zhvillimore, prirja e secilit lider politik në Kosovë është pengimi. Edhe nëse tejkalohej kjo situatë dhe konstituohet kuvendi e formohet qeveria... na presin kriza të reja sepse prirja e liderëve politikë është pengimi.

Tash e 261 ditë janë shpallë zgjedhjet. Tash e tre muaj u mbajtën ato. S'ka ende as Kuvend e as Qeveri. E më e keqja është se s'ka as zhvillime tjera politike që burojnë nga partitë e zgjedhura. Shkoni në WayBack Machine dhe kërkoni në portalet

tuaja të preferuara për zhvillimin e fundit të këtij lloji. S'ka! Do t'iu duhet të ktheheni deri në marsin e vitit të kaluar.

Çështja pra është se rrëfimet e mëdha të tri partive politike në Kosovë kanë kollapsu. Asnjëra s'ka më mesazhe kryesore. S'ka narrativë. S'ka kundërnarrativë. Kollaps total! Rivaliteti mes palëve s'e frymëzon askënd më sepse bazohet thjesht në disa mbeturina të një të kaluarë në të cilën s'duam të jetojmë më. Nevojat qytetare janë shumë më të mëdha. Ndërkohë, duhet thënë edhe se sistemi ynë politik s'e duron shumë teatralitetin meqë ndodhet përherë në kërkim të zgjidhësve të problemit. E zgjidhës problemesh s'kemi.

Qytetari i Kosovës duhet t'i shporrë këta liderë politikë prej jetës së tij. Secilin një nga një. E di që është e zorshme të imagjinohet tash për tash, por duhet të ketë kërkim kolektiv për alternativë tjetër. S'mund të jenë Albin Kurti, Memli Krasniqi e Lumir Abdixhiku krejt çka ofron shoqëria jonë.

Qesharake, e frikshme, e rrezikshme: Elaborimi i Trumpit për Serbi-Kosovë

Nga Tjetër*

Rrini, rrini edhe pak këtu!

Deklarata e fundit e presidentit amerikan Donald Trump për Kosovën dhe Serbinë ishte njëkohshëm qesharake, e frikshme dhe rrezikshme.

Qesharake

Qesharake sepse në atë deklaratë – që kushedi pse, nuk mori vëmendje të madhe në Kosovë – ai harroi emrin e shtetit tonë, Kosovës.

“Serbia po bëhej gati të shkonte në luftë me...” – nisi fjalën e tij Trump në Zyrën Ovale të Shtëpisë së Bardhë. Qartazi ai po provonte në një letër para vetes të gjente emrin e Kosovës por nuk po ia dilte.

“Serbia po bëhej gati të shkonte në luftë me... ëëëë... me një grup që s’do t’ia përmendi fare sepse (shyqyr) nuk ndodhi dhe ia dolëm ta ndalnim.” – përfundoi fjalinë e tij presidenti amerikan.

Ishte deklaratë qesharake edhe shkaku i formulimit të shkujdesshëm kur e sheh më në fund emrin e shtetit tonë, Kosovës.

“... s’do ta përmendi që është Kosova, por është Kosova!”

E frikshme

Ishte deklaratë e frikshme sepse tregonte sa pak i bënte presidentit amerikan për Kosovën. Ai nënkupton se e ndaloi një luftë të Serbisë me Kosovën duke i thënë Serbisë që do ta ndalte tregtinë me ta.

Tregtia e Serbisë me Amerikën është më pak se 5 për qind. Amerika s’është mes top-10 vendeve me të cilat Serbia bën shkëmbime tregtare, qoftë import e qoftë eksport.

Është deklaratë e frikshme sepse nënkupton që nëse nesër na sulmon Serbia, do ta pësojë thjesht me një përçindje të vogël të tregtisë së saj.

E rrezikshme

E rrezikshme sepse e minon rolin e KFOR-it në Kosovë. Domethënë, sipas asaj që deklaroi Trumpi, nëse Serbia futet në Kosovë trupat paqeruajtëse të KFOR-it thjesht vëzhgojnë si spektatorë futbollit?!

Është deklaratë e rrezikshme edhe sepse mund ta inkurajojë sjelljen destabilizuese të Serbisë. Vuçiqi pas kësaj deklarate mund të mendojë që nëse e pëson vetëm në tregti, atëherë pse të mos e rris sjelljen veçse destabilizuese të tij në raport me Kosovën, por edhe me Bosnjen?!

Nejse, duhet ta themi që deklaratat e Trumpit nuk bazohen në fakte konkrete. Ai po flet për Marrëveshjen e 4 shtatorit 2020. Për ata që e mbajnë mend, ajo kohë ishte relativisht e qetë sa i përket tensioneve ndër-etnike. Larg më e qetë se situata e viteve të fundit. Prandaj, ka shumë gjasë që Trumpi po ekzagjeron (për të mos thënë që po rren).

Nejse. Më poshtë e keni të plotë deklaratën e Trumpit për Kosovën (më problematikja deri tash).

Deklarata e transkriptuar:

“Serbia, po bëhej gati të shkonte në luftë me...ëëëë... me një grup që s’do ta përmendi fare sepse nuk ndodhi dhe ia dolëm ta ndalnim. Por, e kam një mik në Serbi... dhe ata thanë që do t’ia nisnin luftës përsëri dhe... ëëë... s’po e përmendi që është Kosova por është Kosova. Ata do ta bënin një luftë të madhe. Ne e ndalëm. E ndalëm shkaku i tregtisë. Ata donin tregti me Shtetet e Bashkuara e unë iu thashë që ne s’bëjmë tregti me njerëz që shkojnë në luftë.”

Deputeti ukrainas që lobon për Kosovën bën jehonë të madhe ndërkombëtare

Nga Tjetër*

Deputeti ukrainas që ka bërë fushatë të madhe për njohjen e Kosovës nga vendi i tij ka shkaktuar mjaft bujë në parlament në periudhën më të vështirë politike që prej nisjes së agresionit rus në shkurt 2022. Dhe, e mori një fitore të madhe që do ta rris peshën e fjalës së tij. Oleksiy Honcharenko kishte bërë fushatë në Parlamentin e Ukrainës për njohjen e Kosovës. Ai madje edhe e kishte vizituar vendin tonë. Kësaj here, ai e nisi një transmetim LIVE për të treguar se si kolegët e tij në procedurë të përshpejtuar po e shtynin përpara një legjislacion të kundërshtuar fuqishëm edhe me protesta nga ukrainasit. “Miq, ja se si parlamentarizmi po na shkatërrohet në Ukrainë,” – u shpreh z. Honcharenko. Honcharenko është prej pak politikanëve në parlamentin e Ukrainës që e ka mbushur zbrazëtinë e pezullimit të transmetimit të seancave live të parlamentit, raporton Reuters. Ata u ofrojnë ndjekësve të tyre përditësime reale të zhvillimeve në parlament, e të cilat ndihmuar në rritjen e pakënaqësisë qytetare për ligjin kontrovers që i cungon dy agjenci kundër korrupsionit. Shkaku i rreziqeve të sigurisë, seancat e parlamentit të Ukrainës s’ishin transmetuar më live pas invazionit të Rosisë më 2022. @tjetermagazine Pse ukrainasit u zemëruan me Zelenskin dhe ia nisëm protestave?! #tiktok #viral_video #follow #tjetermagazine #fyp #dhezipahiri #kosova #diaspora #demokrasi #lufta #ukraina #zelensky #kuvendikosoves #politika #shqiptare ? original sound – tjetermagazine Por, Honcharenko me disa anëtarë tjerë të opozitës e mbushi këtë zbrazëti. Veçanërisht e bujshme kishte qenë përcjellja e votimit të fundit e shtyrë para nga partia e presidentit Zelensky, e për të cilën ata thonë se u përshkua nga shkelje të shumta procedurale që ishin dokumentuar online nga Honcharenko dhe të paktën një deputet tjetër opozitar. Pak minuta pasi kishte kaluar ai ligj, disa prej influencerëve më të rëndësishëm ukrainas, e rritën zemërimin e protestuesve ukrainas që dolën nëpër rrugët e Kievit dhe qyteteve tjera për të protestuar. “Besoj se kjo bëri dallimin e madh për t’i shtyrë njerëzit të thoshin “Jo, kjo s’është në rregull. Kjo s’është Evropë,” – tha Honcharenko, i vetmi deputet që videot nga parlamenti i shfaq live. Protestat e mëdha patën efekt. Zelensky u zbraps nga presioni prej politikanëve të rëndësishëm evropianë. Deputetët do ta shqyrtojnë rikthimin e agjencive anti-korrupsion të enjten. A do të ishte mirë që deputetit që lobon pro-Kosovës t’i rritet popullariteti? Pa dyshim se po. Bëjani follow a subscribe ku ta shihni. Njohja nga Ukraina do të kishte shumë domethënie.

Surroi e Vllasi u nxehën aq shumë me Jugosllavi sa eskaluan në sharje ndaj Demaçit

Nga Jetlir Buja

Nuk më pëlqejnë titujt sensacionalistë e alarmistë. Por, ajo që ndodhi në episodin e fundit të podkastit të Veton Surroit ishte sensacionale e ishte për alarm. U shfityrua e poshtërua në mënyrë aq të skajshme veprimtaria e Adem Demaçit sa s'duke ndryshe veçse veprimtari qesharake.

Ky episod titullohej "Si e bërmë shtetin në Jugosllavi" në të cilin Veton Surroi provonte përmes Azem Vllasit ta ndërtonte narracionin se Kosova kishte shijuar liri e barazi nga viti 1968 e deri më 1981 dhe himnizohej vepra e Josip Broz Titos. Pra, Kosova e kishte një farë shteti gjatë kësaj periudhe 13-vjeçare.

Në këtë rast – këtu – Surroi po përpiquej që përmes Vllasit të tregonte se si në Jugosllavinë e asaj kohe kishte liri politike të atij niveli sa lejohej të debatohej edhe tema nëse Kosova mund të ishte Republikë brenda Jugosllavisë.

Aq shumë eskalohet në idenë se kishte liri të madhe politike e pluralizëm, sa e gjithë disidenca në Jugosllavi duket banale. Dhe natyrisht, banalizohet prej Vllasit dhe Surroit.

"Debatet kanë qenë... marrshin frymë njerëzt vëlla... ni qasje kritike... çka ka ndodhë? Najkush e ka tepu po... asi..." – Vllasi (44:00 – 44:09)

Mos po mungon diçka këtu? Mos i ka mbajtur dikush 28 vjet burgun natyrisht, është totalisht e pavërtetë. Çka i thonë kësaj përveçse përdhosje e shëmtuar e historisë së Kosovës dhe njëres prej figurave më frymëzuese të saj?!

"Adem Demaçi ka qenë ndër t'parët që shkoi n'burg për...ëëë... ni arsy tjetër... Adem Demaçi e ka pasë opcionin për bashkimin. Ai iu ka përmbajtur asaj t'Bujanit... edhe qysh ka qenë prej natyre ai... aty-këtu ka folë, kanë thanë paja ti këtu se kjo nuk o temë... ëëë, nuk o temë... Edhe e kanë gjyku... ai... ka pasë ithtarë t'vet se te na si t'shkojsh n'burg ki ithtarë, s'ka problem..." – Vllasi (44:10 – 44:47)

Domethënë, Adem Demaçi shkoi në burg për dy arsye: 1) sepse e gaboi temën; dhe 2) sepse ka pasë natyrë problematike.

E gaboi temën sepse foli për Bashkim me Shqipërinë. Kishte natyrë problematike sepse fliste.

Dhe, shiheni se me çfarë inati flet Vllasi për popullaritetin e Demaçit. Nënkupton se ai ishte "kurrkushi". Se i bëri ithtarët e vet thjesht dhe vetëm sepse "shkoi në burg".

Mirëpo, kjo përdhosje s'përfundon këtu. Vllasi e quan edhe "inatçor" Adem Demaçin duke nënkuptuar se ndoshta kjo ishte arsyeja pse ai përfundoi për 28 vjet në burg. Ishte inatçor.

"Ka dalë prej burgu... Ademi edhe prej natyre u kanë pak inatçor. I grahke asaj t'vetes. Edhe ka shku apat..." – Vllasi (44:53 – 45:00)

A tha diçka Veton Surroi përveç që e nxiste Vllasin dhe kënaqej me fjalët e tij?! Natyrisht që tha. Është edhe më zi se Vllasi.

"Kanë pasë nevojë strukturat e sigurisë, pro-serbe, me kriminalizu veprimin politik të shqiptarëve. Edhe osht dashtë me pasë një Adem Demaç a dikon a, cilindo me kapë... e me thanë, fjalët e tij janë kriminale... na e majmë n'burg..." – Surroi (45:37 – 45:59).

Pra, Adem Demaçi s'kishte kurrfarë veçantie në veprimtarinë politike në Jugosllavi. Ai ishte kurrkushi. Ata mund ta kapnin cilindo, veç që ta jepnin një shembull. Sipas Surroit, Adem Demaçi ishte thjesht një viktimë që u përdor nga strukturat e sigurisë pro-serbe kundër shqiptarëve.

A duhet Parlamenti Evropian me ia heqë fotografinë? Mos duhet me ia marrë edhe Çmimin Sakharov?

Sipas Surroit dhe Vllasit po. Vetëm e vetëm që një fshatar me katër vjet shkollë si Josip Broz Tito të dukej sa më mirë dhe të mos i qortonte nga varri.

Mbrojtja e Vllasit për Titon shkon deri aty sa e relativizon edhe disidencën e njohur ndërkombëtarisht në mbarë botën të Milovan Djilasit. Lë të kuptohet sikur Djilasi i kishte rënë pishman për disidencën e tij e për burgun e tij. Gjë që natyrisht, është totalisht e pavërtetë.

Çka i thonë kësaj përveçse përdhosje e shëmtuar e historisë së Kosovës dhe njëres prej figurave më frymëzuese të saj?!

Shkrimi në Evropë që tregon qysh biznesmenët po i kapin mediat e Kosovës

Nga Tjetër*

Është një shkrim që po shpërndahet me të madhe dhe e sot nga zyrtarët e Vetëvendosjes. Por, duket që ata të cilët po e shpërndajnë ose nuk e kanë lexu deri në fund ose... s'e njohin gjuhën angleze as në nivel elementar.

Shkrimi është goxhaaaaa rëndues ndaj Vetëvendosjes.

Kurthi me Devollët?

Aty disa gazetarë të Klan Kosovës – në kushte anonimiteti – thonë që nuk janë leju me raportu keq për bizneset e Devollëve. Përmendet një rast kur ShBA i kishte vënë embargo dyshekëve Comodita, e një gazetar thotë që s'iu ishte lejuar të tregonin pse.

Po ashtu, thuhej që Shkëlqim Devolli i kishte mobilizuar punëtorët e Klan Kosovës kundër Qeverisë Kurti. Iu kishte thënë që Kurti mund ta mbyllte Klan Kosovën dhe ata mund të mbesnin pa punë. Uh! Mos i kemi dëgju këto më herët?!

Dorën në zemër, shkrimi është shumë i dobët dhe s'ofron asgjë të re sa i përket Devollëve. Klan Kosova ballëlartë e kurrizdrejtë i promovon bizneset e pronarëve në edicione qendrore të lajmeve. Dhe, Devollët haptas kishin dalë me komunikatë ku thonin se Kurti donte t'i mbyllte.

Hajt mendoni, cili medium në Kosovë qe 25 vjet ka pasë guxim me raportu k undër bizneseve të pronarit të vet?! Përmendeni një të vetëm.

Klan Kosova bile bën kronika televizive për Bajram te xhamia e babës së Devollëve. Një gazetar i Klan Kosovës s'mundet me shkru as kundër asaj xhamie, se lëre më kundër bizneseve të Devollëve. Dhe kjo as që do diskutim. Është gjë e keqe. Por, nuk është një e keqe që bëhet tinëzisht. E shohim përmes televizionit të tyre. Na e kallëzojnë vet Devollët.

Në Tjetër ne kemi tregu qysh ka ndërru për një ditë politika editoriale e Klan Kosovës në raport me Vetëvendosjen në një ditë të ftohtë janari. Pse kishte ndërru? Aty e gjeni thelbin e mënyrës qysh Devolli operon me Klan Kosovën. Qe ku e keni më poshtë:

Sidoqoftë, artikulli s'ndalet te Devollët. Ne spekulojmë që i përdori Devollët sa me i futë në kurth aktivistët e VV-së.

ATV e TëVë1

Në atë shkrim tregohet qysh pronarët e ATV-së – që janë edhe pronarë të AAB-së – nuk kanë leju me u raportu asnjë kritikë për Ministrinë e Arsimit të Arbërie Nagavci prej vitit 2022 e deri më 2024.

Një gazetar i tyre foli për këtë gjë. Pra, pronarët e ATV-së s'i lejuan të shkruanin për një institucion që udhëhiqet nga

Vetëvendosje. A është normale që një pronar të ketë frikë nga hakmarrja nëse transmeton storie kritike?! Kjo s'është mirë për VV-në.

Më pas, një gazetar i TëVë1 – shkrimi është aq i dobët sa as emrat e televizioneve nuk i ka shkruar si duhet – thotë që e kishin pasë të ndaluar me shkru keq për Ministrinë e Xhelal Sveçlës. Veç merreni me mend: këtë send e kanë shpërnda VV-ja duke mendu se është mirë për ta!

FUND

Që disa biznesmenë të mëdhenj qëndrojnë prapa mediave të Kosovës kjo dihet. Ajo që s'dihet bash mirë është qysh funksionojnë reklamat. A reklamon edhe dikush tjetër përpos shokëve e bashkëpunëtorëve të pronarit?!

Mënyra qysh funksionon kapja është larg më e nuancuar edhe pse tepër transparente. Po e përsërisim: gazetarët në Kosovë jo që s'mund të shkruajnë keq kundër bizneseve të pronarit, por as kundër bizneseve të jaranave të pronarit. E portalet as kundër bizneseve që ua japin veç nga 500 euro.

S'ka nevojë për burime këtu.

Nejse, ndoshta gjatë javës tjetër e bëjmë një video që e mbajmë qartë e mirë se qysh funksionon skena mediale në vendin tonë për me kuptu më mirë çka po themi.

Tjetër është medium i pavarur. Pse? Sepse ne punojmë pa pare, pa asnjë cent. Nuk e kemi prapa askënd.

P.S. Në asnjë formë ky vështrim nuk nënkupton relativizim të ndërhyrjes së pronarëve të mediave në redaksitë e tyre. Por, thjesht paraqitëm banalitetin e një situatë që veçse është e njohur gjerësisht edhe nga vetë shikuesit meqë shfaqet hapur nga gazetarët.

Rita Knudsen: Kush është gruaja e Albin Kurtit?

Nga Tjetër*

Shpesh është folur në Kosovë për gruan e kryeministrit Kurti. Disa kritikë të këtij të fundit ia përmendin një farë promovimi të librit në Beograd. Disa të tjerë rrejshëm pretendojnë se ajo punonte e jetonte në Beograd. Në këtë video, Tjetër i hodhi një shikim më të kujdesshëm Rita Augestad Knudsenit – gruas së kryeministrit Albin Kurti dhe një hulumtuese e respektuar. Pasqyrojmë punën kryesore të saj sa i përket Kosovës dhe se çfarë reputacioni akademik ka. Videoja fokusohet vetëm në informacione publike të verifikuara. Në këtë video do ta shihni se profili i saj është shumë më mbresëlënës se që mendonit. Prandaj, të mos humbim kohë e t'i japim fund pallavrave – me fakte, jo me thashetheme. Diku në mars të vitit 2014 u bë e ditur se Albin Kurti ishte martuar. Gruaja e tij ishte një norvegjeze me emrin Rita Augestad Knudsen. Por, pavarësisht kanë kaluar njëmbëdhjetë vjet prej asaj martese, dhe burri i saj është bërë politikani më popullor në Kosovë, Rita Knudsen vazhdon të mbetet e mbështjellur me një tis misteri te publiku kosovar. Nga të dhënat publike në dispozicion gjëja e parë dhe më e rëndësishmja që mësohet është se znj. Knudsen është hulumtuese e lartë në institutin norvegjez NUPI. Ky është një institut kërkimor me reputacion goxha të fortë. Te NUPI ajo punon që njëzet vjet, prej kohës kur Albin Kurti e çeli Vetëvendosjen. Çfarë bindjesh ka znj. Knudsen dhe çka e lidh me Kosovën? Shkaku i profilit të ulët që mbante është e pamundur të dihet me detaje se kur saktë erdhi në Kosovë në vitet 2000'. Por, dihet që erdhi shkaku i kërkimeve të saj akademike. Ajo nisi të punonte në përgatitjen e një raporti pikërisht për NUPI-n e Norvegjisë mbi procesin e privatizimeve. Ideja thelbësore e këtij raporti që po e prezanton këtu ishte se zyrtarët ndërkombëtarë privatizimin në Kosovë e konsideruan si çështje teknike e jo si çështje politike. Me këtë gjë, znj. Knudsen nënkupton mospërfshirjen e kosovarëve në vendim-marrje. Dhe siç e dimë, kjo ishte e vërtetë. Ky prezantim në vitin 2010, që e gjeni në faqen e Rit Kosovo në Youtube, duhet thënë se nuk i shkoi aq mirë. Audienca ishte paksa më shumë se që duhej kritike duke lënë përshtypjen se ajo s'e kishte testuar e elaboruar sa duhet hipotezën bazë. Madje edhe presidenti i Universitetit Amerikan në atë kohë, Chris Hall, shprehet kritik në lidhje me atë se sa reale ishte ajo çka po argumentonte znj. Knudsen. Një zyrtar i Zyrës së BE-së në Kosovë reagoi dy herë gjatë këtij prezantimi duke përmendur madje edhe një vlerësim të jashtëm që i ishte bërë procesit, e i cili nuk ishte përfshirë në raportin e znj. Knudsen. Ajo çka znj. Knudsen e shtron në atë raport është e përfaqësues – megjithëse shumë më e nuancuar – me bindjet e shprehura në atë kohë nga burri i saj për privatizimin dhe gjithë shtetndërtimin si proces në Kosovë nga faktori ndërkombëtar. Nëse e mbani mend, Albin Kurti me aktivistët e VV-së i kishte bërë një grumbull protestash kundër UNMIK-ut duke e denoncuar ashpër qasjen kolonialiste të tyre. Para disa vitesh Rita Knudsen e botoi një libër në një shtëpi botuese prestigjioze dhe ky lajm u bë i ditur nga vet Kurti. Për atë libër, profesori i shquar Samuel Moyn (Mojnë) nga Yale

(Jeillë) University, shkruan : “Studimi i Rita Augestad Knudsen për trajektoren (e vetëvendosjes si koncept) është i paprecedent jo thjesht në kronologjinë e saj që çon gati deri në ditët tona, por edhe në thellësinë dhe finesën konceptuale, duke na kujtuar që kuptimi i koncepteve derivon dhe evoluon në momente kyçe të historisë,” Pra, goxha fjalë të mira, apo jo? Më vonë gjatë karrierës së saj akademike ajo do të merrej edhe me të tjera tema të rëndësishme. Në profilin e saj akademik, znj. Knudsen ka marrë citime në masë të ulët krahasuar me kolegët e saj nga NUPI por deridiku të kënaqshme marrë parasysht fushat specifike në të cilat është fokusuar. Që ta themi troç: gruaja e kryeministrit tonë nuk punon në Beograd por në Oslo, me një institucion kredibil që bën hulumtime të cilat qihmojnë NATO-n e BE-në. Pra, kushdo prej kritikëve të Kurtit që e sulmon përgruan e tij, na besoni që s'e di se çka po flet.

Na kontakto në
"info@tjeter.net"